



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E
LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i
Integruar**

“Mjekësi e Përgjithshme”

Institucioni i Arsimit të Lartë

“Universiteti i Mjekësisë, Tiranë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Majlinda Lako

2. Prof. Asoc. Fabian Cenko

Mars/2020

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Mjekësisë Tiranë ka një histori të gjatë. Ai i ka fillesat e tij që në vitin 1952 me themelimin e Institutit Mjekësor, i cili mori statusin e Fakultetit të Mjekësisë në 1957 dhe më pas Univesitet në 2013.

Programi i studimit Msc në Mjekësi e Përgjithëshme është hapur me VKM Nr. 381, datë 07.06.1952 dhe ky program përgatiste e mjekeve të përgjithshëm.

UMT përbëhet nga tre fakultete: Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Mjekësisë Dentare dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Në 2017, UMT u akreditua për herë të parë nga agjencia britanie e akreditimit QAA në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), për një periudhë kore 5 (pesë) vjeçare.

UMT ofron programe studimi BSc dhe MSc, Specializime Afatgjata dhe Doktorata. Në këto programe është i angazhaur staf akademik shumë i kualifikuar dhe i përkushtuar. Stafi akademik i këtij Universiteti vlerësohet për arritjet akademike dhe mësimdhënien. Për të vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies është krijuar Njësia e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë (NJSBC) e cili është një strukturë e ngritur në nivel Instiutcioni. Një pikë e fortë e programit të integruar të MSc në Mjekësi e Përgjithëshme është mundësia e shkëlqyer për studentët që të jenë në kontakt me pacientët që nga dita e parë që ata bëhen pjesë e këtij Universiteti. UMT ka një mundësi unike për të nxjerrë studentë të klasit të lartë, kërkesat dhe puna e të cilëve kanë ndikim pozitiv tek stafi akademik për të performuar në standardet më të larta. Një përqindje e madhe e studentëve që mbarojnë këtë program studimi, kanë një punësim të suksesshëm si mjekë në vende të ndryshme të BE-së, fakt i cili tregon se cilësia e mësimdhënies së këtij programi është ekuivalent me shumë vende të Evropës. Stafi është i përfshirë në disa Erasmus dhe grante kërkimore Horizont 2020, të cilat siguron dhe forcojnë bashkëpunime ndërkombëtare, si dhe mundësi për të sjellë teknologjitë më të reja në fushën e kërkime klinike në UMT. UMT ka edhe buletinin e vet shkencor, i cili botohet në anglisht katër herë / vit. 10-15 revistat më të mira specifike për punën e secilit departament, ofrohen gjithashtu në mënyrë elektronike për të gjithë stafin akademik, për të siguruar që ata të jenë të informuar me zhvillimet më të fundit në këtë fushë. Si pjesë e promovimit akademik, janë edhe btimet botimi në revistat me faktor impakti, cila është një kriter kryesor, për vlersimin sa më objektiv të stafit.

Studentët e UMT kanë këshillin e tyre, i cili ka një rol të rëndësishëm në transmetimin e kërkesave dhe zërit të studentëve tek stafi akademik dhe administrativ. Studentët kanë mbështetje shumë të mirë dhe kanë pajisjet e nevojshme laboratorike dhe studimore. Rekrutimi i tyre bazohet në udhëzime dhe kritere të përcaktura nga MASR, të cilat kryesisht bazohen në arritjet e studentëve gjatë arsimit të mesëm. Studentët mirëprehen me një guide në facilitet e UMT, ditën e prezantimit që njihin me UMT dhe monitorohen vazhdimisht duke iu ofruar mundësi trajnimit përgjatë periudhës së studimit tyre gjatë vjeçarë. UMT angazhohet në organizimin e aktiviteteve sportive dhe artistike për studentët.

Në përgjithësi, programi i integruar i MSc ofron një kurrikul shumë të mirë, si nga ana klinike dhe ajo akademike.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ju janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmbledh në informacionet të mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standart dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij.

Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Prof. Majlinda Lako ekspert dhe drejtues i GVJ dhe Prof. As. Fabian Cenko ekspertë. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Xhiliola Bixheku, përfaqësuese e ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka qënë i shumtë në numër, i cili ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend.

Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në Fakultetin e Mjekësisë të zhvillua në datat 20 dhe 21 Janar 2020 sipas një axhende gjithëpërfshirëse.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është përpjekur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga UMT në ofrimin e një programi të mirë Master të integruar në Mjekësi të Përgjithëshme, gjithashtu jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin kërkimor, klinik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të mjekëve, stomatologëve dhe teknikëve mjekësorë.

Megjithatë procesi i vlerësimit duhet të përmirësohet me rekomandimin kryesor që dokumentat e kërkuesit nga ASCAL të mos jënë kaq voluminoz, në mënyrë që të lehtësojnë punën grupeve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Më datë 03.03.2020, me shkresë zyrtare Nr. 2/5 Prot., datë 04.03.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 04.03.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 2/6 Prot., date 06.03.2020, Institucioni shprehet se nuk ka komente rreth Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, ky i fundit kthehet në raport final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Integruar “Mjekësi e Përgjithshme”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I INTEGRUAR

| Standardi I.1 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi master i shkencave në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi “Master i shkencave” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, u krijua në vitin 2013 nga një eksperiencë e sukseshme prej më shumë se 6 dekadash si pjesë e Universitetit të Tiranë, dhe me qëllimin e gjithëpërfshirjes në një universitet të lartë publik të shkencave mjekësore dhe kërkimit shkencor mjekësor [Ev. 1] [Ev. 7]. |
| Kriteri 2. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është institucioni publik, që synon arsimin e lartë gjithëpërfshirës të studentëve vendas e të huaj, studimet dhe kualifikimet e mëtejshme, kërkimin shkencor dhe veprimtarinë mbështetëse në fushat e shkencave në fushën e mjekësisë. Qëllimi i këtij universiteti është zhvillimi i arsimit, edukimit dhe kërkimit shkencor në fushën e mjekësisë [Ev. 4]. UMT kontribuon në formimin e profesionistëve në fushën e shëndetësisë dhe specifikisht të mjekësisë, në përputhje me interesat kombëtare dhe institucionet politikëbërëse në fushën e shëndetësisë [Ev.4, 61,62] |
| Kriteri 3. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi i integruar i ciklit të dytë Msc në Mjekësi e Përgjithshme, zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të parimeve të lirisë dhe cilësisë akademike e cila në fushën e mësimdhënies nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese të infrastrukturës, si në aspektin e kërkesave dhe të rezultateve [Ev. 66]. Programi i studimit ofrohet në përputhje të plotë me Statutin e UMT, strategjinë dhe misionin e tij. Ky mision orientohet drejt krijimit, zhvillimit e transmetimit të dijeve në aftësi dhe kompetenca të studentëve, të nevojshme këto, për t’u bërë ekspertë cilësorë të fushës së mjekësisë [Evd.1, 2,3, 4, 61, 66]. |
| Kriteri 4. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Niveli profesional i shërbimit mjekësor konsiderohet si një nga përparimet më të theksuara të shëndetësisë dhe kjo për shkak të përkushtimit të Fakultetit të Mjekësisë, UMT, nëpërmjet përgatitjes së dhjetra breza mjekësh, si dhe duke qenë qendra më e rëndësishme e kërkimit dhe aplikimit shkencor mjekësor, çka ka bërë që arrijtjet bashkëkohore të jenë të pranishme dhe në dispozicion të shoqërisë shqiptare [Ev. 48]. Misioni i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, konsiston në edukimin e studentëve në të tre ciklet e studimit konform standardeve më të larta profesionale; në përgatitjen më të mirë të profesionistëve që të praktikojnë kujdesin optimal ndaj pacientit, të synojnë parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe të çojnë përpara kërkimin shkencor [Ev.1] [Ev. 4] |
| Kriteri 5. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor; | Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin e UMT dhe ka për qëllim jo vetëm të ofrojë njohuri dhe aftësi profesionale, por të përgatisë |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | studentët dhe të diplomuarit me aftësi dhe kompetenca të thelluara që ndihmojnë në vijimin e studimeve të thelluara edhe në ciklin e tretë [Evd.61-66]. Konkretisht, në vijim të programit të studimit të integruar 6 vjeçar, Fakulteti ofron programe studimit të ciklit të tretë specializime afatgjata [ev.60], si dhe programe të doktoratës (aktualisht pezulluar nga MASR), sipas RVB. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi I.2

Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Programi i studimit Mjekësi e përgjithshme ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional, statutin e UMT si dhe me aktet rregullatore ku janë të parashikuara struktura, zhvillimi dhe organizimi i programeve të studimit. UMT është i vetmi institucion publik që ofron numrin më të lartë të programeve të studimit dhe vetëm në fushën mjekësore, në përputhje edhe me emërtimin e tij. Si një institucion me profil mjekësor, emërtimi i programit të studimit “Master i Shkencave” në “Mjekësi e Përgjithshme” është në përputhje të plotë edhe me linjat dhe drejtimit e zhvillimit institucional [Ev.4, Ev1]. |
| Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | UMT, ne kuadër të ndryshimeve ligjore në fushën e arsimit të lartë në vitet e fundit, edhe në Statutin e ri (miratuar në shtator 2019) ka për qëllim zhvillimin e prioritetëve akademike të programit të studimit. Referuar RVB dhe evidences 5 janë ngritur grupet e punës për harmonizimin e akteve rregullatore me statutin e ri. |
| Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit. | Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” në “Mjekësi e përgjithshme” është në përputhje me nivelin 7 të kualifikimit të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (KSHK) [Evd.49] dhe zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit mjekësor, bazuar në njohuri shumë të specializuara, të avancuara, bashkëkohore në fushën e mjekësisë dhe duke kërkuar një bashkërendim dhe me fusha të tjera. |
| Kriteri 4. Programi i integruar i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit | Statuti i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, bazohet në lirinë akademike, autonominë financiare dhe organizative dhe programi i integruar në Mjekësi e përgjithshme zbatohet në përputhje me rregullat dhe parimet e hapësirës europiane të arsimit të lartë, ligjin për arsiin e lartë, aktet përkatëse nënligjore, dhe gjithë dokumentat themelore përkatëse. [Ev. 3] [Ev. 58]. Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me aktet rregullatore të institucionit, prioritetet e zhvillimit strategjik të institucionit dhe në ndjekë linjën e zbatimit të strategjisë kombëtare të zhvillimit të vendit në fushën e shëndetësisë [Ev. 62]. Objektivat e programit të studimit janë të formojë liderë të ardhshëm në shërbimin mjekësor, në përputhje me ndrysimet e shpejta dhe të mëdha të arritjeve teknologjike; të prodhojë aktorë të rëndësishëm me njohuri specifike, profesionalitet të lartë në shërbimet mjekësore për komunitetin sin ë aspektin parandalues ashtu edhe në trajnimin dhe reabilitimin e sëmundjeve në |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | nivel individual dhe komunitar. [Ev. 61] | | | |
| | Ky program studimi, sic është cituar dhe më lart, sot mbart traditën shumëvjeçare të formimit universitar publik duke paraqitur të vetmin institucion akademik në fushën e shkencave mjekësore nga një anë, por dhe duke ofruar në vijimësi ekspertizën më të lartë profesionale në arsimimin dhe përgatitjen shkencore bazuar në standardet më të larta shkencore ndërkombëtare [Ev. 26]. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi I.3**Programi i integruar i studimit synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| Kriteri 1. Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës. | Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë në Mjekësi të Përgjithshme, ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve me njohuri të thelluara shkencore dhe kompetenca profesionale në përputhje me profilin e programit. Programi synon formimin e profesionistëve të ardhshëm të shëndetit, të orientuar drejt kudesit mjekësor të mbështetur mbi fakte; vlerësimi të cilësisë dhe performancës së shërbimeve; mjekësisë së integruar që ofrohet në grupe multispecialistike duke siguruar dhe respektuar një partneritet etik mes mjekut dhe pacientit. [Ev. 61-66]. Programi i integruar i studimit për shumë vite ka qenë program i vetëm i ofruar në nivel kombëtar (deri në vitin 2002), dhe aktualisht ruan një pozicion elitare, si lidhur me cilësinë e studentëve të regjistruar (në hyrje) [Ev. 44] ashtu dhe me cilësinë e studentëve në dalje [ev.56]. |
| Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Përqëndrimi te cilësia dhe në përputhje me respektimin e standardeve të mësimdhënies bazuar në kapacitetet e strukturave ndihmëse e bëjnë këtë program të ofrojë profesionistë cilësorë që orientohen nga nevojat e tregut, dhe i shërbejnë këtij të fundit duke respektuar misionin dhe vizionin e sistemit shëndetësor për popullatën. Studimi i tregut të punës, kryhet mbi të dhënat zyrtare të ofruara nga bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Urdhërin e Mjekut, dhe Shoqatave Profesionale, QSHA për diplomantët që fitojnë të drejtën e ushtrimit të profesionit të mjekut; Të dhënat e Alumni nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta, Edukimin në vazhdim, dela qartazi nevoja për mjeke që ka vendi, kjo mbështetur dhe me numrin e madhe të aplikimeve për këtë program [Ev.43,44, 71]. UMT synon ruajtjen e cilësinë dhe përgatitjen profesionale të mjekëve duke propozuar në mënyrë konstante dhe racionale numrin e kuotave të pranimit, bazuar në kapacitetet optimale infrastrukturore dhe akademike, pavarësisht numrit të lartë të aplikimeve në këtë program studimi [Evd.43, 44]. |
| Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të integruar të studimit, rezultatet e | Program i integruar “Mjekësi e përgjithshme” ka të përcaktuara qartë objektivat formues, strukturën dhe përmbajtjen, kriteret e pranimit, metodat e mësimdhënies dhe të të nxënimit, vlerësimin e njohurive, dijeve, aftësive |

| | |
|---|---|
| <p>prishme të të nxënit garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> | <p>dhe kompetencave të përcaktuara edhe në syllabuset e lëndëve/moduleve përbërëse të programit të studimit. [Ev.61-66] Pas licensimit nga ana e Urdhërit të Mjekut, të diplomuarit mund të punësohen në sektorin shëndetësor, qendra spitalore, qendra shëndetësore, qendra të kujdesit paliativ, qendra të promovimit dhe të konsultimit të shëndetit mjekësor, kërkimit shkencor, akademik. Ligji i profesioneve të rregulluara përcakton modalitetet e fitimit të drejtës së ushtrimit dhe punësimin pas marrjes së të drejtës së liencimit [Ev. 58]. Departamentet si njësi bazë bashkë me shërbimet e ndryshme luajnë një rol të dyfishtë: akademik dhe kërkimor-shkencor si njësi akademike e UMT dhe shërbim terciar diagnostikues e trajtues. Nëpërmjet këtyre strukturave tregu i punës reflektohet në programin e integruar dhe garanton cilësinë e profesionistëve të ardhshëm.</p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p> | <p>Konstatohet se programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare. Kjo referuar procedurave të shkëmbimit të studentëve në kuadër të projekteve (Erasmus, ev.34), të transfërimit të studimeve të kryera në FM [Ev.36, 103], si dhe njohjes me qëllim punësimi të diplomuarve në mjekësi në tregun ndërkombëtar (referuar RVB, T.1, T.4, T.9). Programi i studimit është i hartuar në përputhje me direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara dhe me sistemin e Bolonjës. [Ev.34,36,61-68].</p> |
| <p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disaveçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p> | <p>GVJ konstaton se Fakulteti i Mjekësisë në kuadrin e ndërkombëtarizimit dhe rritjes së njohurive dhe metodave më të fundit në fushën e mjekësisë ka krijuar një rrjet bashkëpunimi me lektorë nga universitete evropiane apo edhe SHBA. [Ev.26] [Ev.82]. Nga ana tjetër, shkëmbimet mes Universitetit të Mjekësisë, Tiranë me universitete jashtë Shqipërisë kanë shërbyer si një mekanizëm shkëmbimi eksperiencash në aktivitetin akademik nëpërmjet mobiliteteve për studentet, stafin akademik dhe atë administrativ. [Ev.31] [Ev.32]. Gjatë tre viteve të fundit në tre kategoritë e mësipërme dukshëm konstatohet një rritje të shkëmbimeve drejt dhe nga UMT [Ev. 34]</p> |
| <p>Kriteri 6. Programi i integruar përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p> <p>Kriteri 7. Në programin e integruar duhet të përfshihen elementë të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p> | <p>Plani strategjik i Universitetit të Mjekësisë Tiranë [ev.4] ka të theksuar rëndësinë e ndërkombëtarizimit të tij dhe për arritjen e këtij objekti, UMT –ja e realizon me një sërë mënyrash: lidhje të marrëveshjeve me universitete të huaj, antarësime në rrjetë ndërkombëtare, nëpërmjet shkëmbimeve në kuadër të projekteve ndërkombëtare apo ndëruniversitare, aktivitete ndërkombëtare etj. Po në këtë kontekst, nga takimin me titullare të institucioni u konfirmua se po hartohet një plan pune për ofrimin e këtij programi dhe në gjuhë të huaj (angeze).</p> <p>Program i integruar në Mjekësi e Përgjithshme është pjesë e i listuar në programet e studimit të Maturës Shtetërore që zgjidhet nga maturantët, programi ofrohet në gjuhën shqipe. Në periudhat kur parashikohen vizita të studentëve të huaj apo cikle leksioneve nga pedagogë të ftuar të huaj, realizohen në gjuhën angleze.</p> |
| <p>Kriteri 8. Për programin e integruar, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p> | <p>Dokumentacioni kryesor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe specifikisht i programit të integruar arkivohet dhe ruhet në institucion në përputhje me rregulloren përkatëse. Që prej 2016, dokumentacioni i programit dhe jo vetëm (kjo lidhur me akreditimin institucional të UMT-së kryer me ekspertë të Agjencisë Britanike të Cilësisë [Ev.15], si dhe të standardeve të cilësisë për këto lloj programesh) ruhen dhe në gjuhën</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | angleze. Dokumentat qe gjenerohen gjate aktiviteteve akademike ruhen ne forme elektronike dhe "hardcopy" ndersa perpunimi dhe aksesimi i tyre kryhen ne respekt te parimit te konfidencialitetit dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. [Ev.52] [Ev.53] [Ev.54] [Ev.131] | | | |
| Shkalla e permbushjes se standardit | Nuk permbushet | Permbushet pjeserisht | Permbushet kryesisht | Permbushet plotesisht |
| | | | | X |

Standardi I.4

Programi i integruar eshte ne perputhje me fushen akademike te njesisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë | Fakulteti i Mjekësisë, për më shumë se 60 vite, është institucioni kryesor publik që ofron edukimin bazë, trajnim dhe aftësim profesional e specializues, si dhe kualifikime shkencore dhe akademike për profesinistët e shëndetësisë në vend [Ev.7]. Institucioni në funksion të programit të studimit ofron burimet dhe kapacitetet akademike me personalitete të njohur të fushës e mjekësisë [Ev.77, 78, 82]. |
| Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Evidentohet cilësia e stafit akademik si nga ana e kualifikimit shkencor (rreth 50% e tyre janë të kategorisë Profesor) ashtu dhe nga kompetencat/aftësitë diagnostikuese/klinike që zotërojnë për shka dhe të marrëdhënies së integruar që kanë me qendrat spitalore universitare (referuar RVB, T1, T5). Programet kryesore që aktualisht FM ofron, formojnë mjekë, mjekë të specializuar, farmacistë, specialistë të shëndetit publik [Ev.60]. Personeli akademik që mbulon programin e integruar të studimit në Mjekësi të Përgjithshme është përzgjedhur bazuar në fushat specifike akademike dhe në eksperiencën praktike e profesionale sipas kuadrit ligjor në fuqi. [Ev.7] [Ev.35]. Sipas referencave në RVB, në Fakultetin e Mjekësisë janë të punësuar 480 personel akademik (personel i brendshëm, i shërbimeve shëndetësore të strukturave universitare, si dhe staff i jashtëm), 49 personel ndihmës akademik dhe 23 personel administrative [Ev.59] [Ev.75] [Ev.76]. |
| Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njesisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Plani mësimor i masterit të integruar i përcaktuar sipas llojit të veprimtarive, lëndëve (syllabuseve) dhe organigramës së departamenteve siguron një sinergji me kërkimin shkencor në këto sektore dhe ofrojnë për studentët një mbështetje të plotë në procesin e të mësuarit, të përfshirjes në aktivitete shkencore dhe atë final të përgatitjes së diplomës finale. [Ev.55] [Ev.63] [Ev.64] Fushat specifike të studimit, të përfaqësuara nga shërbimet shëndetësore të veçanta krijojnë një mundësi bashkëpunimi mes studentëve të masterit të integruar dhe atyre të programeve të ciklit të tretë (shkollat e specializimeve) të cilat garantojnë një model pune në ekip dhe ndërthurje kontributesh me një përdorim efikas të personelit akademik në këto shërbime. [Ev.17] [Ev.60] Në dinamikën e evolucionit të njohurive të shkencat mjekësore, modulet përberëse apo syllabuset e lëndëve të masterit të integruar, rishikohen/përditësohen periodikisht sipas procedurave të përcaktuara nga |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | Universiteti [Ev.46] [Ev.47] GVJ konstanton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | UMT ka si mision kryesor formimin e profesionistëve të fushave së mjekësisë si dhe përgjegjësinë e ofrimit të një edukimi cilësor dhe me standartete duke ndarë dhe organizuar punën në të gjitha hallkat e strukturës akademike dhe administrative [Ev1,3,4]. Institucioni ka një historik shumëvjeçar në ofrimin e programeve të studimit, tashmë ka një traditë të organizimit dhe ndarjes së detyrave akademike dhe administrative. Specifikisht në Statutin dhe Rregulloren UMT, Rregulloren e Fakultetit të Mjekësisë, në organigramat përkatëse, në rregullore të tjera specifike, konstatohet një ndarje e qartë e roleve dhe koordinimit ndërmjet strukturave erberëse si dhe autoriteteve drejtuese, gjithashtu mes njësisë bazë të FM (Departamenteve) dhe shërbimeve spitalore universitare në mbështetje të mbarëvajtjes së aktivitetit didaktik dhe kërkimor – shkencor. [Ev.59] [Ev.62] GVJ konstanton se kriteri përmbushet plotësisht. |
| Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj. | Referuar RVB si dhe takimeve të realizuara (stafin akademik, studentët, përgjegjësit e departamenteve) evidentohet fakti që në formimin të studentëve të mjekësisë, ndikojnë faktorë si: cilësia në hyrje e studentëve, cilësia e pëersonelit akademik, kurrikul bashkekohore dhe e konsoliduar, si dhe marrëdhënia e ngushtë (e sanksionuar kjo me me akte nënligjore [Ev.17] qendrat spitalore universitare ne vend. |
| Kriteri 3. Për realizimin e programit të integruar të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Shërbimet në bazë specialiteti është struktura që në mënyrë organike bën efektive kët marrëdhënie. Shërbimet kanë një funksion të dyfishtë: nga ana akademike shërbimi është pjesë përberëse e departamentit (e njesise bazë), dhe njësi bazë e strukturës shëndetësore universitare (spitaleve universitare). Konkretisht, strukturat shëndetësore universitare ofrojnë standardet më të mira shëndetësore në vënd ne lidhje me edukimit, trajtimin dhe kërkimin shkencor: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, 2 Spitale Universitare Obstetrike – Gjinekologjike, Spitali Universitar i Traumës. [Ev.17] [Ev.50]. Pranë këtyre strukturave zhvillohen pjesa klinike/diagnostike e formimit të tyre dhe synohet të mbështetet përfshirja e tyre në veprimtarinë kërkimore shkencore pranë tyre. |
| Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të | Bashkëpunimi mes Fakultetit të Mjekësisë dhe Strukturave Spitalore |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| studimit që ofron. | Universitare bazohet në akte rregullative si dhe organigramën e një pjese të përbashkët të personelit akademik të përfshirë në aktivitetin diagnostik/terapeutik dhe atë të mësimdhënies, e cila e bën këtë program studimi unik dhe zgjidhjet për mbarëvajtjen e tij të veçanta krahasuar me universitetet e tjera. [Ev.50] [Ev.27] [Ev.28] | | | |
| Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve. | Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është një aktor shumë i rëndësishëm për rrjetin e bashkëpunimit në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në vënd. [Ev.26] [Ev.27] Nëpërmjet personelit akademik cilësor, dhe politikave mbështetëse UMT ka firmosur marrëveshje me institucione të tjera akademike jashtë Shqipërisë në kuadrin e bashkëpunimit në fusha të caktuara me interes të përbashkët. [Ev.34] | | | |
| Kriteri 6. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit | Marrëveshjet me institucione të tjera shprehin fleksibilitetin për të identifikuar modele të qëndrueshme bashkëpunimi në shërbim të interesave të veçanta të zhvillimit sic është bashkëpunimi me Fakultetin e Ekonomisë për krijimin dhe konsolidimin e një Masteri në Menaxhim Shëndetësor që (i) buron nga eksperiencia e moduli pjesë e programit të studimit në Mjekësi të Përgjithshme; (ii) shpreh nevojën e tregut për figurën e menaxherit në kontekstin specifik të ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime shëndetësore; dhe (iii) realizon një pjesëmarrje formim multidisiplinar (jo vetëm mjekë dhe ekonomistë por edhe juristë etj). [Ev.86] Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit për çdo vit akademik harton raporte analitike mbi mbarëvajtjen e bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare [Ev. 33]. Rezultatet e bashkëpunimeve bëhen publike dhe të aksesueshme për gjithë stafin akademik dhe studentet nëpërmjet leksioneve të hapura si edhe përditësimit të literaturës të përdorur në programin e studimit. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore-shkencore të personelit akademik dhe studentëve. | Si institucioni publik më i madh në shkencat mjekësore, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, përmban profesionistët më të spikatur në fushën e shëndetësisë dhe kontributi i tyre është i lavdërueshëm jo vetëm në aktivitetet klinike/diagnostike por edhe në fushën e kërkimit shkencor. Realiteti i aplikimeve në aktivitete të kërkimit shkencor me fonde kombëtare dhe ndërkombëtare është një provë e interesit dhe arritjeve në këtë drejtim. [Ev.30] [Ev.108] |
| Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | GVJ konstatoi se në Fakultetin të Mjekësisë janë dy struktura të ngritura të cilat kanë për qëllim mbështetjen e personelit akademik në pjesëmarrjen në aktivitetet e kërkimit shkencor: (i) Bordi Shkencor si organ kolegjal këshillimor pranë dekanit për strategjinë afatgjatë të kërkimit shkencor dhe garantimin e cilësisë në këtë proces; dhe (ii) Zyra e projekteve dhe edukimit në vazhdim me rolin e mbështetjes dhe inkurajimit të iniciativave duke përfshirë edhe mbështetjen administrative. [Ev.59] [Ev.106]. |
| Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. | |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimorebotuese.</p> | <p>Referuar raportit vjetor të kërkimit shkencor, konstatohet pjesëmarrja e FM në disa projekte të rëndësishme ndërkombëtare dhe kombëtare si psh: (1) Euroscreen mbështetur nga KE (Horizon 2020); (2) ImplementAll, strategjitë për e-health (Horizon 2020); (3) MINDUP mbështetur nga KE (Horizon 2020); (4) TASOIP mbështetur nga BE. [Ev.107].</p> <p>Në situatën aktuale kur mundësitë e financimit të kërkimit shkencor janë të shumta, do të sugjerohet fuqizimin e strukturave të sipërcituara, për tu përgjigjur në kohë reale thirrjeve të projekteve kërkimore shkencore dhe jo vetëm.</p> <p>Në mbështetje të promovimit të aktivitetit kërkimor, FM ka në dispozicion Revistën shkencore “Neë Bulletin of Medical Sciences ISSN”, kurse UMT ka vendosur në dispozicion “The Albanian Journal of Medical and Health Sciences” (AJMHS) ISSN. [evidencat përkatëse bashkelidhur RVB]. Në këto dy revista personeli akademik dhe studentët inkurajohen të botojnë aktivitetin kërkimor.</p> <p>GVJ nga diskutimet me përfaqësues të personelit akademik, Zyrën e projekteve, konstatoi se interesi personelit në përfshirjen në projekte kërkimi ishte i lartë, kjo duke përfshirë dhe interesin personal të individit në promovimin e saj/tij të karrierës. Po në këto takime u evidentua fakti që pengesat burokratike të natyrës ligjore që lidhen me tërheqjen e fondeve europiane dhe vështirësitë në respektimin e rregulloreve të donatorit, kjo për shkak të legjislacionit shqiptar për financat publike (sic edhe konsiderohen këto fonde në momentin që bëhen pjesë e buxhetit të institucionit përfitues). Fakulteti i Mjekësisë aplikon dhe zbaton më mire projekte ku ka ekskluzivitetin e pjesëmarrjes, kjo mbështetur dhe ne evidencën 107.</p> <p>Revista shkencore e Fakultetit të Mjekësisë ofron një platformë ku jo vetëm inkurajohën rezultatet e kërkimit shkencor, por edhe promovohet cilësia nëpërmjet standarteve që aplikon bordi shkencor i saj (Neë Bulletin of Medical Sciences, me ISSN online 2521-0327. Print ISSN 2521-0319. [Ev.110] [Ev.111] [Ev.112]. Një tjetër mundësi ku studentët dhe kërkuesit shkencor janë të inkurajuar të botojnë, duke rritur edhe standardin e tyre të kërkimit shkencor është edhe buletini shkencor i Universiteti Mjekësor, Tiranë: The Albanian Journal of Medical and Health Sciences.</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor</p> | <p>Në mbështetje të promovimit të aktivitetit kërkimor, FM ka në dispozicion Revistën shkencore “Neë Bulletin of Medical Sciences ISSN”, kurse UMT ka vendosur në dispozicion “The Albanian Journal of Medical and Health Sciences” (AJMHS) ISSN. [evidencat përkatëse bashkelidhur RVB]. Në këto dy revista personeli akademik dhe studentët inkurajohen të botojnë aktivitetin kërkimor.</p> <p>GVJ nga diskutimet me përfaqësues të personelit akademik, Zyrën e projekteve, konstatoi se interesi personelit në përfshirjen në projekte kërkimi ishte i lartë, kjo duke përfshirë dhe interesin personal të individit në promovimin e saj/tij të karrierës. Po në këto takime u evidentua fakti që pengesat burokratike të natyrës ligjore që lidhen me tërheqjen e fondeve europiane dhe vështirësitë në respektimin e rregulloreve të donatorit, kjo për shkak të legjislacionit shqiptar për financat publike (sic edhe konsiderohen këto fonde në momentin që bëhen pjesë e buxhetit të institucionit përfitues). Fakulteti i Mjekësisë aplikon dhe zbaton më mire projekte ku ka ekskluzivitetin e pjesëmarrjes, kjo mbështetur dhe ne evidencën 107.</p> <p>Revista shkencore e Fakultetit të Mjekësisë ofron një platformë ku jo vetëm inkurajohën rezultatet e kërkimit shkencor, por edhe promovohet cilësia nëpërmjet standarteve që aplikon bordi shkencor i saj (Neë Bulletin of Medical Sciences, me ISSN online 2521-0327. Print ISSN 2521-0319. [Ev.110] [Ev.111] [Ev.112]. Një tjetër mundësi ku studentët dhe kërkuesit shkencor janë të inkurajuar të botojnë, duke rritur edhe standardin e tyre të kërkimit shkencor është edhe buletini shkencor i Universiteti Mjekësor, Tiranë: The Albanian Journal of Medical and Health Sciences.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | X |

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1

Programi i integruar i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| <p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> | <p>Organizimi i studimit në programin e integruar të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në Mjekësi të Përgjithëshme, bazohet në përmbushjen e detyrimeve ligjore në fuqi të përcaktuara nga Ligji nr. 80/2015 dhe aktet e tjera plotësuese dhe në respekt të statutit dhe rregullores se UMT, rregullores se Fakultetit të Mjekësisë dhe asaj të vetë këtij programi.</p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p> | <p>Programi është i mirëorganizuar në lëndë/module të cilat i përkasin ndarjes në kategori përkatësisht: lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmblylëse. [EV.61] Ndarja e krediteve sipas kategorive përcakton edhe prioritetin dhe plotësueshmërinë e informacionit në modulet përkatëse ku lëndët karakterizuese kanë 60% e totalit të krediteve, lëndët bazë 23% dhe lëndët ndërdisiplinore dhe plotësuese 7% të krediteve të programit dhe 3% në fund detyrimi i punimit të diplomës. [Ev.63]</p> |
| <p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorieve dhe parimeve akademike të fushës.</p> | <p>Programi i studimit përmban forma të ndryshme mësimdhënie në funksion të procesit të diskutimit dhe të kuptuarit të problemeve dhe zgjidhjeve përkatëse sic janë Leksionet, Seminaret, Labororet, Praktikat lëndore dhe ato klinike. [Ev.65] Raportet mes formave të mësimdhënies janë në shërbim të specifikave dhe fushave të ndryshme mjekësore sipas lëndëve përkatëse ku leksioni si forma e tradicionale e paraqitjes së informacionit përfaqëson 42% të oreve, ndërsa seminari dhe praktika klinike në shërbim të diskutimit të thelluar pranë shtratis të sëmurit nga 25% të programit secila. [Ev.64]</p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe praktike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Ai synon pajisjen me njohuritë të thelluara teorike dhe kompetenca profesionale, të duhura që tju mundësoje studentëve ndjekjen e ciklit të tretë të studimit. [Evd.61-66].</p> |
| <p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> | <p>Përmbajtja e lëndëve/moduleve të programit të studimit përfiqet të aftësojë mjekun në detyrat e tij të lidhura me nevojat që ka popullata nga njëra anë, por edhe të ketë bazat e avancimit të ekspertizës mjekësore përgjatë ciklit të tretë (shkollat e specializimit dhe proramet e doktoraturave). [Ev.60]</p> |
| <p>Kriteri 6. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p> | <p>Përballë trajtimeve dhe patologjive gjithnjë e më të ndryshme, mjekësia në cdo kohë kërkon inovacionin për të rritur eficiencën e saj, por paralelisht është sfiduar në kërkimin e mënyrave gjithmonë e më të arrira për të komunikuar dhe aftësuar mjekët në kryerjen e këtij misioni [Ev.60] [Ev.98] [Ev.117].</p> |
| <p>Kriteri 7. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuara kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p> | <p>GVJ konstaton se programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e një programi studimi, në përputhje me ligjin 80/2015 dhe akte të tjera rregullative [Ev.61-68] Ai është organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), realizohet në 6 vite studimi/12 semestra/15 javë secili semestër dhe 360 ECTS në total i organizuar në module (grup lëndësh) sipas kategorive të formimit sic përcakton kuadri ligjor.</p> <p>Cdo lëndë/modul pjesë e këtij programi është e analizuar në raport me njohuritë që duhet të përmbajë dhe aftësitë që duhet të transmetohen tek studenti, rezultatet e pritëshme nga ky proces dhe metodologjia e vlerësimit të këtyre rezultateve, tekstet që përmbajnë informacionet më të përditësuara (në shqip – literatura e detyruar dhe në gjuhë të huaj – literaturë e rekomanduar) dhe numrin e orëve dhe të krediteve. Rishikimi i detyruar i</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>syllabuse-ve është një dokumentim i reflektimit të dinamikave të njohura të zhvillimit të shkencave mjekësore. [Ev.64]</p> <p>Përmbajtja e lëndëve shërbejnë në formimin e mjekut në rolin dhe detyrat e punësimit të tij si mjek i përgjithshëm. Numri i orëve dhe përmbajtja e këtyre lëndëve dhe modalitetet e zhvillimit të tyre duhen që në mënyrë parësore ti shërbejnë këtij qëllimi. Për këtë arsye, duhet synuar gjithmonë e më shumë që praktikat klinike të studentëve të simulojnë natyrën e shërbimit shëndetësor parësor i cili është edhe punëmarrësi kryesor i të sapodiplomuarve nga ky program i integruar i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në Mjekësi të Përgjithëshme. [Ev. 61 - 66]</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi II.2 | |
|--|---|
| Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | <p>Programi i integruar i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në Mjekësi të Përgjithëshme ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë (njësi kryesore). FM ka në përberje të tij 16 departamente (njësi bazë). Fakulteti është njësi që organizon dhe koordinon planin mësimor, ndërsa departamentet kontribuojnë në realizimin e këtij plani. [Ev.58] [Ev.59]. Në vijim janë listuar departamentet si pjesë përberëse e FM:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti Morfologjise - 2. Departamenti i lëndëve BioMjekësore dhe Eksperimentale - 3. Departamenti i Sëmundjeve të Brëndëshme - 4. Departamenti i Laboratorëve - 5. Departamenti i Semiologjisë Klinike dhe Imazherike - 6. Departamenti i Sëmundjeve të Zembrës dhe Enëve të Gjaktut - 7. Departamenti Sëmundjeve Infektive dhe të Lëkurës - 8. Departamenti i Kirurgjisë - 9. Departamenti i ORL – Okulistikës - 10. Departamenti i Pediatrie - 11. Departamenti i Neuro-Shkencës - 12. Departamenti Obstetrik – Gjinekologjisë - 13. Departamenti Anatomisë Patologjike, Mjekësisë Ligjore - 14. Departamenti i Mjekut të Familjës, Sëmundjeve Profesionale - 15. Departamenti i Farmacisë - 16. Departamenti i Shëndetit Publik- <p>Specifikat e programit të studimit Mjekësi e Përgjithëshme lidhet me numrin e madh të departamente të cilat përmbajnë një numër të madh personeli akademik dhe me tituj. Drejtuesi i departamentit është përgjegjës për shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me personelin akademik, profilin dhe kualifikimet që kanë. [Ev.3] [Ev.58] [Ev.64].</p> |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | |
| Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar. | |
| Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | |
| Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj. | |
| Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në | |

| | | | | |
|---|--|-------------------------------------|------------------------------------|---|
| <p>rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> | <p>Fakulteti i Mjekësisë përbëhet nga 16 departamente të cilët përmbushin kriteret ligjore për organizimin dhe strukturën akademike (evidencë lista e PAE sipas departamenteve, organigrama e FM)</p> <p>Fakulteti i Mjekësisë, plotëson kërkesat ligjore lidhur me numrin e departamenteve (Ligji 80/2015 përcakton se fakulteti duhet të ketë minimalisht 3 departamente; personelin akademik i punësuar me kohë të plotë është jo më pak se 7 për cdo departament nga të cilët 3 me titull/gradë shkencore). FM ka në përbërjen e tij 16 departamenti, numri i personelit akademik është 194 personel akademik efektiv [Ev.77].</p> | | | |
| <p>Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p> | <p>GVJ në takimin me përgjegjësit e departamenteve (T1) si dhe në evidencat përkatëse, konstatoi se hërndarja e ngarkesës mësimore bëhet çdo fillim viti akademik në përputhje me normativat e ngarkesës mësimore sipas akteve nënligjore në fuqi; bazuar në nevojat për mbulimin e disiplinave/lëndëve përkatëse identifikohet kërkesa për personel akademik me kontratë. [Ev75.]</p> <p>Fakulteti i Mjekësisë, për vitin akademik 2018-2019 referuar RVB janë angazhuar 231 personel akademik efektiv nga të cilët 96% (194) me tituj akademik dhe gradë shkencore. Ndërsa personeli akademik me kontratë, për të mbuluar nevojat për lëndë të ndryshme është 196 nga të cilët 59 % (114) me tituj shkencorë. [Ev.77]</p> <p>GVJ konstatoi se në FM janë të punësuar staf ndihmës akademik në mbështetje të cilët kanë rol të rëndësishëm në zhvillimin e programit të studimit Gjithsej rezultojnë 37 personel ndihmës akademik [Ev.76]</p> <p>Programi i studimit në të gjithë aspektet përbërës planifikohën, zhvillohen dhe vlerësohen nga 16 njësitë bazë të Fakultetit të Mjekësisë në raport me rolin dhe detyrat e tyre përgjatë këti programi. [Ev.58]. Roli i koordinatorit njësohet në detyrat dhe përgjegjësitë e zëvendës-dekanit për anën mësimore i cili koordinon ecurinë dhe zhvillimin e leksioneve, praktikave klinike etj dhe garanton përvijimin dhe ndjekjen e objektivave të programit. [Ev.59] [Ev.66]</p> <p>Të gjitha proceset e vendimmarrjes në funksion të programit të studimit që kanë nevojë për miratim, diskutohen gjerësisht e miratohen në dekanat. Koordinator bashkëpunon me rrjetin e studentëve dhe përcjell tek departamentet shqetësimet e tyre lidhur me të gjitha aspektet e programit të studimit sic janë orari, pjesëmarrja e personelit akademik, cilësia e sallave për leksionet, seminarët dhe praktikat etj.[Ev.45]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

Standardi II.3

Programi i integruar i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të integruar të ciklit të dytë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

| | |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> | <p>Autoriteti kryesor në organizimin dhe garantimin e mbarëvajtjes së programit të studimit është Fakulteti i Mjekësisë i cili harton, miraton, rishikon dhe vlerëson dokumentacionin e plotë për të gjithë aspektet e këtij program. [Ev.58-66] Elementë të këtij roli janë:</p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> | <ul style="list-style-type: none"> - Të dhëna të përgjithshme, objektivat formuese, objektivat strategjike, metodat e mësimdhënie, kriteret e pranimit, regjistrimit, transferimit etj; - Rregullorja e programit të studimit, plani mësimor, CV e personalit akademik, - Syllabuset e lëndëve dhe ndarja e tyre sipas veprimtarive formuese në shqip dhe anglisht. |
| <p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës dhe, të ndara në vite e semestra.</p> | <p>Struktura e programit të studimit “Mjekësi e Përgjithshme” përbëhet nga lëndët të cilat janë të organizuara sipas veprimtarive formuese (sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41/2018):</p> |
| <p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p> | <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë, kulturë bazë dhe e përgjithshme e, cila përmban lëndë për një total prej 84 kredite; - Lëndë karakterizuese, për përgatitjen teknike në disiplinën mjekësore, e cila përmban lëndët për një total prej 215.5; - Lëndë ndërdisiplinore/integruese, për formimin ndërdisiplinor dhe të zgjedhura nga studentët, të cilat përmbajnë 23.5 kredite; - Lëndë plotësuese, për zhvillimin e aftësive që lidhen me nevojat që kërkon tregu i punës dhe që lidhen me profesionin e mjekut, me lëndë të cilat përmbajnë 25 kredite; - Detyrime përmbyllëse, që përfshin punimin e tezës së diplomës dhe përfaqëson 12 kreditet finale të një diplome 6 vjeçare ose 360 kredite. |
| <p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p> | <p>Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e një programi studimi sipas ligjit 80/2015, dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore [Ev.61-66] Ai është organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), realizohet në 6 vite studimi/12 semestra/15 javë secili semestër dhe 360 ECTS në total i organizuar në module (grup lëndësh) sipas kategorive të formimit sic përcakton kuadri ligjor (VKM 41/2018). Kreditet janë shprehje e lëndëve/moduleve në raport me rëndësimë dhe kontributin e tyre në formimin e studentit sipas objektivave të të mësuarit, ndarjen sipas semestrave, dhe bazën e procesit të njohjes dhe transferimit të studimeve.</p> |
| | <p>Syllabuset e lëndëve përmbajnë elementët e përcaktuar në shtojcën e VKM nr. 41/2018, sic janë: pasqyra informative e lëndës, konceptet themelore dhe temat e detajuara, bibliografia e përdorur, numri i orëve dhe forma e mësimdhënies, frequentimi, format e kontrollit dhe lloji i vlerësimit final. Në planin mësimor të programit të studimit dhe në syllabuset e lëndëve [Ev.64] paraqiten të dhëna të detajuara mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emërtimin e moduleve të grupuara dhe të renditura në semestra; - Numrin e krediteve për çdo modul dhe raporti i orëve (leksione seminare, laboratorë); - Detyrimet sipas moduleve (seminare, ushtrime, punime, detyra kursi, projekte, praktikë); |

| | | | | | | | | | | | |
|---|--|------------|----------|------------|----------|--------------|---------|--------------------|--------|--------------------|---------|
| | <p align="center">- Mënyrat e kontrollit të dijeve të çdo moduli</p> <p>Format e mësimdhënies, sipas listës më poshtë shprehin edhe specifikat e programit të studimit në shërbim të njohurive dhe aftësive që duhet të krijojnë te studenti:</p> <table border="0"> <tr> <td>- Leksione</td> <td>1692 orë</td> </tr> <tr> <td>- Seminare</td> <td>1011 orë</td> </tr> <tr> <td>- Laboratorë</td> <td>380 orë</td> </tr> <tr> <td>- Praktikë lëndore</td> <td>39 orë</td> </tr> <tr> <td>- Praktikë klinike</td> <td>978 orë</td> </tr> </table> <p>GVJ konstatoi se shpërndarja e ngakesës mësimore siaps formave të mësimdhënies është korrekt dhe ne përputhje me profilin e programit. Kjo mbështet konkretisht në % e ngakesave: 40% e ngarkesës mësimore zhvillohet në formën e leksionit ku informacioni jepet dhe iniciohet procesi i të menduarit klinik, ndërsa 50% në formën e seminarit dhe praktikës klinike ku informacioni fillon të asimilohet si pjesë e situatave konkrete me synimin në krijimin e njohurive të bazuara në praktika klinike. [Ev.62] [Ev.65] [Ev.70]</p> <p>Referuar RVB, evidencave përkatëse si dhe fqes zyrtare të institucionit, GVJ konstaton se procedurat e pranimit të studentëve në programin e studimit janë të përcaktuara në Rregulloren e universitetit, fakultetit dhe rregulloren e programit të studimit [Ev. 3, 58,66].</p> <p>Cdo vit akademik me propozim të Fakultetit, Senati akademik i UMT miraton (kriteri minimal të notës mesatare të arsimit të mesëm së bashku me provimet e maturës shtetërore MVKM) ≥ 8.5).</p> <p>Këto kriterë bëhen publike dhe dërgohen në MASR dhe QSHA për tu njohur nga maturantët. [Ev.36-39]. Procesi i aplikimit është i menaxhuar nga QSHA dhe RASH ndërkohë që UMT bën vetëm renditjen dhe shpalljen fitues të maturantëve në bazë të renditjes. [Ev.40-44].</p> <p>Pavarësisht se regjistrimi dhe transferimi i studimeve rregullohen me akte të përvitshme të MASR, institucioni ka parashikuar procedurën se si kryhen transferimet e studimeve dhe kriteret e përzgjedhjes, transferimi i studimeve, transferimi i studimeve në të njëjtin cikël studimi, procedurat e transferimit, si dhe ekuivalentimi i programeve të studimeve për studentët që transferohen. Rregullorja e universitetit parashikon rastet dhe sasinë e krediteve përkatëse që njihen. [Ev.47,103].</p> <p>Kuotat e transferimeve drejt programit të integruar të Mjekësisë së Përgjithshme në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. [Ev.36] [Ev.103] Rregullorja e UMT parashikon të gjitha rastet e tjera sic janë rastet dhe sasinë e krediteve respektive që njihen, transferimit të studimeve, ekuivalentimin e programit të studimeve etj. [Ev.3] [Ev.38].</p> | - Leksione | 1692 orë | - Seminare | 1011 orë | - Laboratorë | 380 orë | - Praktikë lëndore | 39 orë | - Praktikë klinike | 978 orë |
| - Leksione | 1692 orë | | | | | | | | | | |
| - Seminare | 1011 orë | | | | | | | | | | |
| - Laboratorë | 380 orë | | | | | | | | | | |
| - Praktikë lëndore | 39 orë | | | | | | | | | | |
| - Praktikë klinike | 978 orë | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 6. Programi i integruar i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit</p> | <p>Përmirësimi i vazhdueshëm i programit të studimit është një proces i cili është e rregulluar me procedurat përkatëse. Drejtoria përgjegjëse për kurrikulën inicion cdo vit akademik kërkesën drejt njesive kryesore të UMT për rishikimin/përditësimin e programeve të studimit/të syllabuseve., UMT ka të hartuar dokumenta rregullatore të kryerjes së këtij procesi i cili fillon nga nivelet e departamenteve dhe gjen miratimin final nga Senati i</p> | | | | | | | | | | |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Universitetit. [Ev.46] [Ev.47], për ndryshime deri në masën e përcaktuar nga ligji. | | | |
| Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Në sfidat e sistemit tonë shëndetësor dhe proceset reformatore për kujdesin shëndetësor parësor të cilat janë në një proces analize dhe vlerësimi nga aktorë të ndryshëm brenda vendit dhe ndërkombëtare (si psh Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Urdheri i Mjekut, Organizata Botërore e Shëndetësisë etj). Të dhënat e mbledhura dhe analizuara nga këto raporte përfshihen nga FM me qëllim përmirësimin e kurrikulës nisur nga roli dhe përgjegjësia që kanë kategoria e mjekëve të përgjithshëm në reformat e kërkuara nga sistemi shëndetësor. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Niveli i përmbushjes | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| Kriteri 1. Ngarkesa e programit të integruar të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Ngarkesa mësimore e programit të integruar të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në Mjekësi të Përgjithshme është përcaktuar sipas VKM 41 të datës 24 janar 2018 dhe shpreh ngarkesën ditore/javore në auditor nëpërmjet leksioneve, seminareve, laboratorëve dhe praktikave klinike. Ora e mësimit zgjat 50 minuta, dhe dita/java kanë mesatarisht 5ore/25 orë aktivitet mësimor. [Ev.102] |
| Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Program studimi ka specifikat e tij, të shprehura nga nevoja e praktikave klinike që zhvillohen në ambientet e strukturave shëndetësore universitare. Evidentohet qartë që FM ka bërë të mundur harmonizimin e orareve mes leksioneve, seminareve dhe praktikave në përputhje me grupet e studentëve dhe lëndëve/moduleve të përfshira në programin e studimit në nivel simestral dhe vjetor. Veprimtaritë formuese, shpërndarja dhe numri i krediteve nëpërmjet lëndëve të veçanta, i shërbejnë formimit të studentit të rregjistruar në funksion të dy objektivave në përfundim të programit të studimit: të punësimit të menjehershëm dhe vazhdimësisë së formimit nëpërmjet ciklit të tretë të studimeve. [Ev.62] [Ev.98] |
| Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Aktivitetet formuese, lista e lëndëve përbërëse dhe numri i krediteve, shpërndarja e lëndëve/moduleve sipas viteve dhe format e mesimdhënies janë të hartuara në qëllimin e vetëm për t'i mundësuar studentit që të arrijë objektivat e tij formues në funksion të vazhdimësisë së tij në tregun e punës apo formimin në ciklin e tretë. [Ev.58] [Ev.61] |
| Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në | Ne vijim të këtij synimi, aktivitetet formuese të lëndëve bazë bëjnë pjesë në |

| | |
|---|---|
| <p>kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të integruar “Master i shkencave” dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> | <p>vitet e para të studimit, lëndët e formimit karakterizues dhe ato interdisiplinare në vitetet e mëpastajme, ndërsa lëndët plotësuese përgjatë gjithë kohëzgjatjes së këtij programi. Format e mësimdhënies sigurojnë interaktivitetin dhe stimulimin e të mësuarit aktiv nëpërmjet leksioneve dhe seminareve, dhe më pas sipas specificikave në praktika klinike pranë shërbimeve shëndetësore të Qëndrave Spitalore sipas VKM që rregullon këtë bashkpunim me UMT. [Ev.17]</p> |
| <p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>Programi i integruar të ciklit të dytë në Mjekësi të Përgjithshme është i organizuar në përputhje me ligjin 80/2015 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave 41 të 24 Janar 2008. Sipas këtij të fundit, dhe në përfaqsim me programe të ngjashme ndërkombëtare dhe në respekt të direktivave kombëtare dhe europiane janë përcaktuar lëndët dhe raporti i tyre (orë mësimore/kredite formative), shpërndarja sipas simestrave/viteve dhe syllabuseve përkatëse. [Ev.58]</p> <p>Praktikat klinike janë një aspekt i rëndësishëm i procesit të të mësuarit i cili siguron aftësitë dhe kompetencat sipas nevojave në tregun e punës. Pavarësisht se praktikat klinike përputhen me leksionet përkatëse, studentët janë të inkurajuar (takimi me studentët e viteve të larta) që të kërkojnë sesione shtesë kur e kanë të nevojshme. Specificikat e praktikave klinike kanë evidentuar problematika lidhur me numrin e studentëve (të cilët mund të jene të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë) për numrin e personelit akademik pranë këtyre strukturave të cilat vështirësojnë ndjekjen optimale të studentëve. Kjo është adresuar si zgjidhje nga institucioni, nëpërmjet përfshirjes së mjekëve (primar) pranë shërbimeve (strukturave spitalore universitare) ku zhvillohen praktikat klinike. Kjo do të sjellë uljen e numrit të studentëve në raport me personelin akademik.</p> <p>Deri më tani kanë qënë kufizimet ligjore dhe nënligjore (një grup seminari ka 25 studentë VKM 41/2018), dhe pavarësisht vullnetit të mirë për ti bërë grupe më nr më të vogël, aktualisht janë 10-15 studentë, kjo sjell implikime financiare që do të buronin nga kjo zgjidhje (ritte nr. i grupeve për pasoje ngarkesa mësimore e pedagogëve). Kështu që gjetja e anagazhimit të personelit mjekësor është me profesionalja dhe me e menaxhueshmja.</p> <p>Nga ana tjetër, Pakti për Universitetet, i dakortësuar me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, përcaktoi uljen e tarifave nga të cilat Programi i Studimit në Mjekësi të Përgjithshme është prekur më së shumti për shkak të rezultateve të larta të studentëve në vitin e parë nga arsimit i mesëm, por edhe ato të viteve të mëpastajme gjatë ndjekjes së këtij program. Nga njëra anë ka sjellë uljen e të ardhurave nga ky zë, bazuar në informacionet e mbledhura gjatë takimeve të këtij vlerësimi akreditues, por nga ana tjetër nëpërmjet paktit për universitetin dhe Global Found janë bërë investime në ngritjen e lobaratoreve të simulimit (didaktik) apo në projektimin e korpusit multidimensional [Ev.45]</p> |
| <p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në</p> | <p>Detyrimi i përmirësimit të syllabuseve është administrativisht i rregulluar</p> |

| | |
|---|--|
| <p>mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> | <p>nga Universiteti Mjekësor, Tiranë, nëpërmjet Drejtorise se Kurrikulës dhe Menaxhimit Akademik duke reflektuar trendet e zhvillimit të shkencave mjekësore dhe sistemeve universitare përkatëse. [Ev.46] [Ev.47] Nga ana tjetër, ky proces zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme nga personeli akademik në nivel të departamenteve si rezultat i eksperiencës së fituar nga bashkëpunimi me universitete të tjera ndërkombëtare, konsultimet me partnerë dhe studentët e diplomuar (rrjeti Alumni). Qëllimi i këtij procesi është i shumëfishtë, punësimi në tregun e punës si dhe lehtësimi i transferimit dhe mobilitetit të studentëve në këtë program studimi. [Ev.92] [Ev.94] [Ev.96]</p> |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të integruar të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë.</p> | <p>Fakulteti i Mjekësisë dhe departamentet analizojnë ecurinë e programit të studimit duke përfshirë edhe opinionet e personelit akademik si dhe të studentëve lidhur me çështje të përgjithshme apo edhe të çdo lënde/moduli pjesë e këtij programi. [Ev.45] [Ev.85] [Ev.87].</p> |
| <p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të integruar të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>Syllabuset janë një element kyç i këtij procesi, duke qënë se aty janë të përfshira të gjithë elementët që lidhen me realizimin e objektivave formues te secili student i diplomuar në këtë program. Në përputhje me VKM Nr.41 të datës 24.01.2018, në syllabus përfshihen:</p> |
| <p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të integruar të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p> | <ul style="list-style-type: none"> - pasyra informative; - rezultatet e të nxënit; - konceptet themelore, - temat e detajuara të lëndës, - format e kontrollit të dijeve dhe vlerësimi final; - frekuentimi; - vlerësimi final; - literatura. |
| <p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor mundëson njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p> | <p>Kjo e fundit përcaktohet nga personeli akademik i departamentit dhe përbëhet nga dy pjesë: literatura e detyrueshme (që duhet të jetë në gjuhën e vetë programit – Shqip); dhe literatura ndihmëse (që mund të jetë edhe në gjuhë të tjera – kryesisht English). [Ev.18] [Ev.19]</p> <p>GVJ konstaton se tregu i punës ka nevojë për mjekë të përgjithshme. Kjo ndodh kryesisht për shkak të mobilitetit të mjekëve shqiptarë në vëndë të tjera të Bashkimit Europian, dhe së dyti për shkak të nevojave gjithmonë e në rritje që kanë institucionet shëndetësore jo-publike të cilat kanë njohur një rritje të theksuar gjatë 5-6 viteve të fundit.</p> <p>Nuk duhet harruar që një arsye tjetër lidhet me rritjen e personelit shëndetësor për shkak të një nevojë në rritje si rezultat i tranzicionit demografik me rritjen e jetëgjatësisë mesatare të popullatës e cila ka rritur pjesën e moshës së tretë që është edhe konsumatori më i madh i shërbimeve shëndetësore. [Ev.71]</p> <p>Pavarësisht kërkesave që ka tregu i punës për këtë lloj profesionari, FM propozon kuota optimale pranimit në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore, duke garantuar sigurimin e cilësisë për procesin e të nxënit të studentëve dhe përgatitjen e mjekëve të diplomuar. [Ev.38]</p> <p>Programi i integruar i ciklit të dytë është ndërtuar me qëllim arritjen e objektivave të formimit të stuentit për të avancuar në ciklin e tretë të</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | studimeve. Për të realizuar këtë objektiv, shërben gjithë struktura e programit të studimit në raport me aktivitetet formuese dhe format e mësimdhënies të aplikuara, përfshirja në aktivitetin shkencor në bazë departamenti dhe përgatitja e temës së diplomës. Për më tepër, bashkëpunimi i studentëve me pjesëmarrësit në shkollat e specializimit, sipas shërbimeve ku kryejnë praktikat klinike, favorizon një klimë bashkëpunimi dhe aftësimin e të menduarit analitik në favor të zgjidhjeve të problemeve. [Ev.61] [Ev.61] [Ev.73] [Ev.111] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi. | Kategoritë e personelit të programit të integruar të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në Mjekësi të Përgjithshme janë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> ▪ personel akademik efektiv - me kohë të plotë (PAE) ▪ pesonel akademik i Strukturave Shëndetësore Universitare (PSSHU) ▪ personel akademik me kontratë (PAK) ▪ pesonel ndihmës akdamik me karakter mësimor shkencor ▪ përsoneel administrative. |
| Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të integruar të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. | Personeli akademik plotëson kriteret e përcaktuara nga Ligji i Arsimit të Lartë (LAL) sipas kategorive Profesor, Lektor dhe Asisten lektor. Stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme është punësuar në përputhje me kriteret ligjore dhe institucionale në fuqi. UMT ka të miratuar procedurat e rekrutimit të stafit akademik. [Ev.35,79]. |
| Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | Në organigramën e Fakultetit të Mjekësisë janë të angazhuar 468 personel nga të cilët 426 personel akademik (%) të kategorive PAE, PSSHU, ose PAK), 37 personel ndihmës akademik (%), dhe 23 personel administrative. Në nivel të programit të studimit kontribuojnë 194 personel akademik nga të cilët 76 profesore, 61 Profesore të asociuar, 48 Doktorë Shkencash, dhe 9 Mastera shkencor. Nga këto të dhëna del që 95% e personelit akademik janë me tituj dhe grada shkencore. Stafi me kohë të plotë në përputhje me LAL 80/2015 është i pajisur i gjithë me grada shkencore dhe tituj akademikë dhe të klasifikuar në kategoritë përkatëse. Në FM, në vitin akademik 2018-2019, janë angazhuar në përmbushjen e procesit mësimor 194 personel akademik me kohë të plotë nga të cilët 76 profesore, 61 Profesore të asociuar, 48 Doktorë Shkencash, dhe 9 Mastera shkencor. I gjithë stafi akademik ka grada ose tituj akademik |

| | |
|--|---|
| | <p>Ngarkesa në ore e stafit bazohej në Udhëzimin 29 të MASR. Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik me kohë të plotë në auditor brenda IAL është:</p> <p>a) Kategoria Profesor: 140 orë b) Kategoria Lektore: 165 orë c) Asistent-Lektore 195 orë</p> <p>Cdo orë e realizuar në auditor mbi këtë përcaktim është orë suplementare e cila përlllogaritet sipas koeficienteve dhe paguhet e plotë nga IAL-te. Në raste specifike me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulohe edhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 ore. (udhëzimi i MASR)</p> <p>Personeli akademik me kohë të plotë nese kategorizohet me orientim kërkimor sipas procedurave të parashikuara nga IAL mund të këtë ulje të detyrimit të ngarkesës mësimore në auditor dëri në 35% sipas përcaktimeve në aktet e brendshme të IAL-së. Orët suplementare në auditor për personelin akademik me orientim kërkimor nuk mund të jenë me shumë se 100 orë. GVJ konstaton se stafi akademik zbaton me korrektësi këtë udhëzim. Pavarësisht kësaj në takimin me PA, u evidentua që për shkak të statutit të dyfishtë që ka personeli akademik (njëkohësisht pedagog dhe mjek në shërbim), ngarkesa mësimore etë jetë më e vogël se sa parashikon udhëzimi përkatës i MASR.</p> <p>GVJ mbeshtet sugjerimet dhe kërkesat e UMT, për politikëbërësit, që ky universitet të ketë një status të vecantë për shkak të specifikave që ka.</p> <p>Njësitë bazë, të cilat përballojnë ngarkesën jo vetëm të këtij programi studimi, por edhe të studentëve të ciklit të tretë (shkollat e specializimit dhe programet e doktoraturës) angazhojnë sipas nevojës personel akademik me kontratë. Në totalin e personelit me kontratë shumica vijnë nga Universiteti i Tiranës të cilët mbulojnë lëndët formuese bazë siç janë kimi, biologji, fizikë, sociologji, gjuhë angleze, latine etj).</p> <p>Personeli akademik efektiv (me kohë të plotë) që angazhohet në 16 departamentet e programit të integruar të ciklit të dytë të studimit në Mjekësi e Përgjithshme, janë në përputhje me fushën e programit të studimit, natyrën dhe specifikat e lëndëve/moduleve. [Ev.64] [Ev.69]</p> <p>Personeli ndihmës akademik dhe personeli akademik me kontratë (me kohë të pjeseshme) që angazhohen në veprimtaritë mësimore të këtij programi kanë të gjitha kualifikimet dhe kompetencën e nevojshme për lëndët/modulet ku janë përfshirë. Në CV-të e tyre gjenden ekspserienat dhe kualifikimet e nevojshme që përputhen me fushën e përfshirë.</p> <p>Praktikat klinike, si një nga format e rëndësishme të mësimdhënies të programit, që përbën 25% të progrmit të studimit, zhvillohen nga strukturat shëndetësore të qëndrave universitare të kontraktuara dhe drejtohen nga pedagogë të përzgjedhur nga departamenti. Për vitin akademik 2018 – 2019, nga totali i stafit akademik të raportuar për secilin departament, 145 ishin mjek të punësuar pranë shërbimeve përkatëse nga të cilët 85 (58%) me tituj</p> |
|--|---|

| | | | | |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|-------------------------------------|
| <p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> | <p>shkencor (Profesor i Asociuar ose Doktor i Shkencave). [Ev.78]</p> <p>Në ambientet e Fakultetit të Mjekësisë funksionojnë 20 laboratorë funksionalë në shërbim të praktikave laboratorike siç janë parashikuar në programin e studimit për lëndët/modulet si psh Fiziologjia, Anatomia Normale, Biokimisë, Histologjisë, Mikrobiologjisë, Farmacologjisë, Anatomisë Patologjike, Kirurgjisë, Mikrokirurgjisë Eksperimentale, Komunkimi Mjekësor etj.</p> <p>Për mbajtjen, përditësimin dhe ngritjen e laboratorëve të rinj, Fakulteti i Mjekësisë përveç fondeve (të pakta) që ka në dispozicion, ka siguruar (bazuar në dokumnta) fondet shtesë të nevojshme, nga donacionet dhe projektet ku Fakulteti është i përfshirë në rrjetin e bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. [Ev.145] Një shëmbull është laborator i Stimulimit Klinik i cili do të duhet të ngrihet bazuar në një Marrëveshje mes Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. [Ev.29] [Ev.151]</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimeshshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p> | <p>Perioda e këtij vlerësimi, muaji Dhjetor 2019 – Janar 2020 korrespondoi me post lëkundjet e termetit të cilat u ndjenë kryesisht në Tiranë dhe Durrës me magnitudë 6.4 dhe pasoja në infrastrukturën e këtyre dy qyteteve. Këto pasoja kishin përfshirë edhe infrastrukturën e Universitetit Mjekësor, Tiranë. Gjatë vizitës në 20 – 21 Janar 2020, u verifikuan plan masat e Fakultetit të Mjekësisë për të siguruar një vazhdimësi normale të procesit mësimesor nëpërmjet zhvendosjes së aktiviteteve mësimore në strukturat e padëmtuara dhe rishikimit të oraritme qëllim akomodimin e të gjithë aktiviteteve të planifikuara. Kjo përfshiu edhe shërbimin e laboratorëve të cilët ishin zhvendosur dhe ruajtur funksionaliteti për këtë qëllim.</p> <p>Strukturat laboratorike, personeli ndihmës akademik dhe ai akademik ofrojnë mbështetjen e nevojshme për tezat e diplomimit të studentëve të cilat në bashkëpunim me drejtuesit e temës janë planifikuar të zhvillohen pranë këtyre strukturave.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Asnjë përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe</p> | <p>Universiteti i Mjekësisë, nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulës dhe Menaxhimit Akademik, rregullon administrativisht procesin e vazhdueshëm për përmirësimin e kurrikulës pranë cdo Njësie Kryesore dhe Njësie Bazë. [Ev.4] [Ev.6]</p> <p>Procedura e cila shtrihet në secilin aspekt të lidhur me kurrikulën (siç</p> |

| | |
|---|---|
| partnerëve nga tregu i punës. | është pasqyra e informacionit, argumentat teknik, metodat e mësimdhënies, literaura etj) është i rregulluar dhe kalon në fazat e mëposhtëme: [Ev.46-47] |
| Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit. | <ul style="list-style-type: none"> ▪ Arsyetimi i zhvillimit të kurrikulës bazuar në <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimin e nevojave të tregut; - akte normative/ligjore të miratuara dhe të detyruara ▪ Përafrimi me misionin dhe vizionin e UMT <ul style="list-style-type: none"> - Strategjitë e përmirësimit të metodave të mësim dhënies, - Strategjitë e rishikimit të metodave të vlerësimit - Diskutimi i gjetjeve dhe nevoja për të rishikuar shpërndarjen e ngarkesës <ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i syllabuseve për lëndët/modulet ▪ Përcaktimi i planit të zbatimit të përmirësimit dhe burimet e nevojshme për këtë proces |
| Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit. | Strukturat përgjegjëse për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës konsultohen dhe përfshijnë propozimet e aktorëve kryesorë brenda institucionit por edhe jashtë tij si: |
| Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi. | <ul style="list-style-type: none"> - Urdhri i Mjekut - Qendra e Edukimit në Vazhdim - Qendra e Shërbimeve Akademike - Strukturat shëndetësore universitare |
| Kriteri 5. Në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private, institucioni përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme | <p>Studentët janë një kategori e rëndësishme në komunikimin dhe identifikimin e nevojave për përmirësimin kurrikular të programit të studimit në Mjekësi e Përgjithshme. Jo vetëm cilësia shumë e lartë e maturanëve të rregjistruar në këtë program studimi, por edhe angazhimi dhe rezultatet e larta përgjatë viteve të studimit, njohjet e gjuhëve të huaja i bëjnë një audiencë shumë e preferuar për këtë proces. [Ev.43-44] [Ev.56]</p> <p>Rrjeti i studentëve dhe takimet e tyre formale gjatë procesit të të mësuarit apo edhe pas tij janë një pikënisje opinionesh që mund të vlerësohet nga strukturat dipertamentale. [Ev.87] [Ev.120]. Temat më të interesuara që mund të tejçohen nëpërmjet koordinorëve të cdo grupi/kursi apo këshillit studentor ka të bëjë me llojin e veprimtarive formuese, metodat e vlerësimit dhe shlyerjes së detyrimeve, literatura e përdorur dhe modalitetet e praktikave klinike. [Ev.122]. Këto opinione dhe sugjerime mund të mblidhen në nivel të personelit akademik të njësisë bazë. Përfaqësuesi i studentëve në nivel të Senatit Akademik mund të promovojë çështje të ngritura nga studentët por të mbëctura pa përgjigje nga njësisia bazë. [Ev.14]</p> <p>Rrjeti i studentëve të diplomuar (Alumni) është një burim i rëndësishëm i cili për shkak të nivelit të lartë të emigrimit të tyre në shumë sisteme shëndetësore në vendet e BE, mund të tërheqë opinione interesante që përbashkojnë sfidat e tyre në përpjekjet e ekuivalentimit të diplomës me burimet dhe kushtet në të cilat ky program studimi zhvillohet në kontekstin e Fakultetit të Mjekësisë, Tiranë. Sfidat qëndron në konsolidimin</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>e platformes Gradua (Projekt nderkombetar ku UMT eshte anetare) per ketë kategori profesionsitësh të shpërndarë në të gjithë botën.</p> <p>Mjekët, të diplomuar nga programi i integruar i ciklit të dytë në Mjekësi të Përgjithshme, janë pjesë kritike e burimeve njerëzore në përballimin e sfidave që aktualisht po kalon sistemi ynë shëndetësor. Proceset reformatore në këtë moment kanë përfshirë iniciativa vlerësuese të sistemit të kryera nga aktorë dhe faktorë të rëndësishëm të tij sic janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Organizata Botërore e Shëndetësisë, Fondi i Sigurimeve të Detyruara Shëndetësore, Operatori Shëndetësor, Urdhëri i Mjekut etj. Roli i mjekëve në identifikimin e zgjidhjeve të kërkuara i bën këto dokumenta, dhe autorët e tyre një tjetër burim i vlefshëm që mund të kontribuojë në përpjeket e përmirësimit të kurrikulës së këtij programi në shërbim të aspekteve të ndryshme të lidhur me tregun e punës dhe sfidat e mjekëve në këtë treg. [Ev.132] [Ev.136]</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.7**Programi i integruari studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | <p>Diplomimi në Mjekësi të Përgjithshme nuk synon vetëm punësimin në sektorin shëndetësor, apo thellimin e studimeve në ciklin e tretë të përfaqësuar nga shkollat e specializimit, por konsolidimin e njohurive dhe aftësive për kërkimin shkencor. [Ev.61] Objektivat ambicioze të këtij programi, në aftësimin e studentëve me të menduarit analitik dhe familjarizimin e tyre me metodologjinë kërkimore mbështetet në elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> Lëndët/modulet e e përfshira në planin e studimeve të cilat familjarizojnë studentin me elementët bazë të kërkimit shkencor dhe aplikueshmërinë e tyre në kontekstin mjekësor: Epidemiologia, Metodologia e Kërkimit Shkencor, Biostatistika, Informatika Mjekësore. [Ev.64] Njësitë bazë si pjesë të aktivitetit të tyre është edhe organizimi dhe mbështetja për kërkimin shkencor në fushën e shërbimit të ofruar. Personeli akademik me tituj dhe prania e specialistëve krijojnë kushtet që studentët të përfshihen dhe të kontribuojnë në projekte dhe iniciativa të kërkimit shkencor sipas aftësive dhe interesit që kanë në fusha të caktuara. [Ev.58] Konferencat dhe aktivitetet e edukimit në vazhdim krijojnë mundësitë për studentët që të paraqesin rezultatet e kërkimeve të zhvilluara duke konsoliduar edhe aftësitë lidhur me diskutimin, prezantimin dhe shpërndarjen e këtyre konkluzioneve në përputhje me llojin e audiencës. [Ev.113] [Ev.115] Temat e diplomës, si një detyrim i përmbylljes së programit të |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | |
| Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | |
| Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare. | |
| Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të | |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| ardhurat nga aktivitete të ndryshme | <p>studimit, krijojnë edhe motivimin e studentëve për krijimin e këtyre aftësive dhe vetëdijen e identifikimit të një fushe me interes për tu dedikuar në ciklin e një kërkimi nga mbledhja e të dhënave deri në analizën e të dhënave dhe paraqitjen e rezultateve. [Ev.104] [Ev.139] Bashkëpunimi me drejtuesin e temës së diplomës krijon edhe eksperiencën dhe rrjetin e interesave të cilat mund të vijnë në hapat e metejshëm të karrierës së studentit pas diplomimit. Konferencat shkencore periodike të organizuara nga Fakulteti i Mjekësisë apo shoqatat kombëtare të specialiteteve janë disa nga aktivitetet ku prezantohen këto kontribute. [Ev.108] [Ev.115] Ndërsa punimet shkencore më cilësore të cilat i përgjigjen më mirë një rigorititeti të metodologjisë së kërkimit mund të botohen në buletin shkencor të Universitetit. [Ev.111] [Ev.146]</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mobiliteti i studentëve në universitete të huaja, si pjesë e projekteve si Erasmus +, favorizon ekspozimin dhe përfshirjen e studentëve vizitorë në aktivitete të kërkimit shkencor në universitetet pritëse. Këto ura bashkëpunimi inkurajohen edhe nga vetë personat akademikë të universiteteve dhe shërbejnë në qëllimin më të mirë të këtyre protokolleve të bashkëpunimit. [Ev.30] [Ev.32-34] • Fakulteti i mjekësisë favorizon kërkimin shkencor për studentët duke eliminuar çdo tarifë dhe njëkohësisht duke inkurajuar trajnime me fokus në kërkimin shkencor të përshtatura për audience të studentëve të programit të integruar të ciklit të dytë në Mjekësi të Përgjithshme. <p>Në fund, ajo që e bën kërkimin shkencor një fushë ku mundësitë për përmirësime në të ardhmen janë më të mëdha sesa arrijtjet aktuale bazohen në sa më poshte:</p> <ol style="list-style-type: none"> Përfshirja e stafit akademik në kërkimin shkencor është një indikator moral dhe personal i plotësisht të këtij detyrimi në funksion të vijueshmërisë së karrierës akademike. Lidhur me rritjen e fondeve nga vetë Njësia Kryesore për kërkimin shkencor do të mundesonte edhe një mekanizëm cilësor të kërkimit shkencor nëpërmjet botimit të artikujve në revista shkencore me impakt të lartë. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë, nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e

Si institucioni i vetëm publik që koordinon programin e integruar të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në Mjekësi të Përgjithshme, ka një personel akademik ku 50% e tyre janë Profesor ose Professor i Asociuar, ndërsa cilësia e studentëve që regjistrohen është ndër më të lartat mes të

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | gjithë programeve të studimit në vënd. [Ev.44] [Ev.69] [Ev.77] Rrjedhimisht, cilësia e mësimdhënies dhe kompetencat që transmetohen studentëve garantojnë njohuri të thelluara mjekësore si dhe në fushën e kërkimit shkencor duke ofruar një platformë optimale për të financuar me fonde të mirëfillta iniciativa për kërkimin shkencor. | | | |
| Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | Aplikimet për kërkimin shkencor janë përgjigjur dhe kanë stimuluar pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve të FM. [Ev.34] [Ev.108] Në raport me fondet e vënda në dispozicion nga AKKSHI, për kërkimin shkencor, Fakulteti i Mjekësisë ka marrë pjesë dhe ka fituar aktualisht dy projekte. [Ev.30] | | | |
| Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave | Ndërsa ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësisë është një objektivi i llogjikshëm përderisa është institucioni i vetëm publik nga dalin 95% e mjekëve të përgjithshëm në vënd, cilësia dhe benefite në këto bashkëpunime dhe në kërkimin shkencor pritet të sjellë mes të tjerave edhe financime të drejtpërdrejta të shoqëruara me objektiva konkret. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| | |
|---|--|
| Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për shkak të natyrës specifike të programeve të studimit ka adoptuar dhe përdorur një gamë të gjërë metodash në mësimdhënie. Pjesëmarrja aktive dhe të menduarit aktiv kërkon aplikimin e metodave të ndryshme të diskutimit të informacionit në shërbim të rritjes së njohurive dhe praktikave lidhur me objektivat e formimit të studentëve të këtij program. [Ev.61] [Ev.117] |
| Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Lëndët/modulet, sipas grupit të veprimtarive formuese ku bëjnë pjesë ofrohen nga pedagogë të ndryshëm duke krijuar lirinë akademike që të aplikojnë forma të ndryshme të cilat vënë në qendër studentin dhe informacionin në shërbim të kuptuarit të problemit dhe analizës së zgjidhjeve alternative. |

| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p> | <p>[Ev.117]</p> <p>Metodat klasike të mësimdhënies: (i) leksione, (ii) seminare, (iii) ore laboratorike, (iv) praktika lëndore, dhe (v) praktikë klinike mund të alternohen me mëyra të ndryshme që vënë në qendër problemin rreth të cilit ndërtojnë diskutimin e informacionit të nevojshëm. Materjalet e shtypura, ato elektronike, artikuj shkencore apo module të edukimit në distance përbëjnë burimet e informacionit që mund të aplikohen nga personeli akademik lirisht ne funksion të objektivave të formimit të studentit për secalën lëndë/modul. [Ev.61]</p> |
| <p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> | <p>Metodat inovative të mësimdhënies, shërbejnë si një instrument për personelin akademik i cili vlerëson përthithjen e informacionit në mënyrë kritike nga ana e studentit duke konsoliduar këtë eksperiencë dhe kthyer në një model të standartizuar për t'u replikuar dhe përshtatur. Disa nga modelet janë:</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p> | <ul style="list-style-type: none"> - Shërbimet e Google Education, si Google-Site apo Google classroom, të cilët përdoren kryesisht për mësimdhënien e informatikës mjekësore si lëndë e programit të studimit. [Ev.118] - Stimulimi klinik është një plan i afërt i Universitetit Mjekësor, Tiranë, në bashkëpunim me një investim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me qëllim interaktivizimin e të nxëniet të studentit në çështjet klinike nëpërmjet përdorimit të teknologjisë për simulimin virtual, anatominë 3D, edukimit në distancë etj. [Ev.29] [Ev.151] - Në të ardhmen e afërt janë në zbatim LMS (Learning Management System) dhe platforma Moodle si aplikacione dhe platforma që lehtësojnë komunikimin e studentëve me pedagogun duke rritur ndërveprimin dhe dokumentuar procesin e të nxëniet dhe përditësimit të njohurive. [Ev.29] [Ev.57] <p>NJSBC (Njësia e Sigurimit të brendshëm dhe Cilësisë) ka detyrën të monitorojë dhe vlerësojë aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Pyetesorët për studentët dhe pedagogët [Ev.13] [Ev.97] lejojnë mbledhjen e informacioneve esenciale nga bashkërendimi i të cilave prodhohen analizohen të dhënat dhe prodhohen raporte që përcaktojnë cilësinë e mësimdhënies. [Ev.12] NJSBC realizon këtë proces në nivel rektorati. Ndërsa në nivel të njësisë kryesore kryehet nga dekanati dhe njësia bazë.</p> <p>Departamentet monitorojnë mësimdhënien dhe veprimtaritë e personelit akademik dhe ndihmës akademik ne funksion të lëndëve/moduleve përkatëse. Procesi nis me përcaktimin e ngarkesës për personelin akademik dhe më pas bërjen e një plani monitorimi të këtij aktiviteti. [Ev.141] Në nivel të Njësies Kryesore, duke alternuar metodat, nëpërmjet sekretarisë mësimore apo me grupe ad-hoc, ndjekin respektimin e orarit, zhvillimin e programit dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të parashikuara në programin e miratuar.</p> <p>Studentët janë pjesë e këtij procesi monitorimi duke garantuar pjesëmarrjen e Këshillit Studentor të Fakultetit të Mjekësisë (KSFM) në procesin e vlerësimit</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | dhe analizës nga ana e Universitetit dhe Njësisë Kryesore. [Ev.45] [Ev.120] [Ev.122] | | | |
| | Në diskutimet me personelin akademik, përfaqësues të Njësisë Bazë të Fakultetit të Mjekësisë, u përmend dhe nevoja në rritje për përditësimin e vazhdueshëm e aftësive të tyre me njohuri rreth pedagogjisë së shkencave mjekësore, e cila ishte në prioritet të Fakultetit. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi III.2 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është institucioni publik më i madh dhe i rëndësishëm në formimin e personelit shëndetësor nga dalin pothuajse të gjithë mjekët e përgjithshëm të diplomuar. [Ev.3] [Ev.58] Metodat e transmetimit të njohurive tek studentët janë shumta dhe planifikimi i tyre bëhet në bazë të llojit të veprimtarisë formuese [Ev.61] por edhe lirisë së veprimit që ka personeli akademik në zbatimin e metodave të reja të mësimdhënies. [Ev.117-118] |
| Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij. | Nderthurja e teorisë me praktikën në pothuaj të gjitha lëndet/modulet e formimit bazë dhe specifik, përfshirja e studenteve dhe marrja e mendimeve të tyre, mundëson realizimin me sukses të veprimtarive të parashikuara [Ev.62] Fakulteti mundëson infrastrukturen e nevojshme për të plotësuar nevojat që kanë lëndët/modulet e ndryshme të profilit klinik, si dermatologji, kirurgji, traumatologji etj, për tu realitar në shërbimet e qendrave spitalore universitare. [Ev.50] [Ev.123-124] |
| Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | Fakulteti disponon infrastrukture cilësore në funksion të realizimit të procesit mësimor. Godina mirëmbahet vazhdimisht në sajë të mbështetjes së njësisë kryesore dhe asaj institucionale. Si një nga rinovimet me të rëndësishme në vitet e fundit përmendim rikonstrukcionin e 4 laboratoreve të lëndëve profesionale si Laboratori i Analizës së Drogave (1), Laboratori i Përgatitjes Galenike (1), Laboratori i Përgatitjes Kozmetike (1), Laboratori i Toksikologjisë (1), të cilët u pajisen me banko pune dhe kapa me standarde bashkekohore. Gjithashtu janë rikonstruktuar edhe disa salla leksionesh dhe seminaresh si dhe zyrat e personelit akademike. [Ev.123] |
| Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas | Sallat kryesore janë pajisura me sistem audio-vizive (projektorë) ndërsa laboratorët me infrastrukturen e nevojshme për realizimin e praktikave |

| | |
|--|--|
| tematikave dhe profilit. | mësimore e profesionale [Ev.123-124] |
| Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Ngarkesa mesimore per personelin akademik dhe studentët është shpërndarë ne menyre te tille qe te mundësoje ngarkesë normale te studenteve ne perputhje me nornat sipas kuadrit ligior ne fuqi specifrikisht jo me shume 25 ore javore ne auditor. Ne ketë shpërndarje përfshihen edhe format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve ku çdo lendë/modul ka specifikat e veta [Ev.61] [Ev.63]. Çdo syllabus përmban të gjitha specififikimet e parashikuara në VKM. 41/2018, përfshire format e mesimdhënies, mësimnxënies dhe vleresimit te njohurive [Ev.64] |
| Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimi. | Format e kontrollit të dijeve bazohet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin perfundimtar te lendes/modulit/programit: testimet ndërmjetese, vlerësimi i praktikave laboratorike/klinike, mbrojtja e detyrave dhe e projekteve të ndryshme, provimi perfundimtar, mbrojtja e temave të diplomave [Ev.73] |
| Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | <p>Personeli akademik është gjithmone i hapur drejt aplikimit të formave dhe mënyrave, metodave alternative te mesimdhënies e mësimnxënies në përputhje me fushen dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Eksperienca shumëvjeçare e personelit akademik [Ev.69] është e ndërthurur me personelin e ri duke mundësuar në këtë mënyrë vijueshmeri te traditës se krijuar por njekohesisht implementimin e metodave të reja te mesimdhënies. [Ev.117]</p> <p>Fakulteti dhe personeli akademik jane te angazhuar te sigurojnë infrastrukturen e duhur mesimore/ laboratorike dhe klinike, tekste mësimore dhe materiale te tjera ndihmese në funksion te studenteve [Ev.126] Falë marrëveshjeve të firmosura nga FM dhe UMT, personeli akademik dhe studentet mund të shfrytëzojnë librarite on-line si Ulibrary-EBSCO, Hinari etj si dhe botimet shkencore te universitetit.</p> <p>Ne formimin teorik e praktik rol kryesor zene: leksionet, seminarret, ushtrimet, punet laboratorike, praktikat klinike, detyrat e kursit, projektet e kursit, etj. Ne perfundim te secilit modul është parashikuar zhvillimi i provimit perkates. [Ev.64]</p> <p>Te gjitha format dhe metodat mesimdhënies te paraqitur me siper dhe te parashikuara në programin e studimit, synojne pergatitjen e studentit me aftesite profesionale qe sigurojne pavaresi mendimi e veprimi, e përfshirje në vendimmarrje dhe gjykime [Ev.61]</p> <p>Nderkohe, shfrytezimi i infrastruktures te qendrave spitalore universitare është ndihmesë mjaft e madhe ne funksion te mesimdhënies dhe aftësimi praktik te studenteve me raste klinike në pacientë realë. [Ev.50]</p> <p>Si personeli akademik edhe strukturat pergjegjese, jane të angazhuar maksimalisht qe studentit ne perfundim të studimeve te tij te dëshmoje se</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | zotëron keto njohuri, aftësi dhe kompetenca dhe të jete profesionist i vërtete ne fushën e saj/tij. [Ev.71] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | Per realizimin e programit te studimit Msc. Mjekësi janë përgjegjëse të gjitha strukturat e FM. Procesi mësimor për programin e studimeve kryesisht zhvillohet në ambientet pranë Fakultetit dhe në hapësirat e përcaktuara të Strukturave Shëndetësorë të Qëndrave Spitalore përkatëse. |
| Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave. | UMT referuar aseteve infrastrukturore në pronësi të tij, me një sipërfaqe rreth 20.000 m2 (nga të cilat 14,958 m2 në funksion të procesit mësimor dhe 5,000 m2 në funksion të veprimtarisë administrative), disponon auditore, klasa, laboratore, mjedise për stafin akademik, salla mbledhje, salla kompjuterësh etj. |
| Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. | FM zhvillon aktivitetin mësimor dhe ka në dispozicion të personelit akademik ambientet si vijoj: - Godina kryesore: 16 zyra, 1 bibliotekë 40 vende - Auditorium Falilei-Galileo: 1 sallë William A. Johnson 13 vende, 2 zyra; - Godina e Farmacisë dhe Shëndetit Publik: 6 klasa 25 vende secila, 19 zyra, 10 laboratore, 2 preparatore, 1 sallë leksionesh 80 vende; - Godina e Lendeve Paraklinike nr.1 ▪ Kati parë: 3 zyra, 3 klasa seminaresh, 1 muzeum, 1 laborator 60, 35, 35 vende ▪ Kati dytë: 1 salle leksionesh 80 vende, 5 laboratorë, 12 zyra, 6 klasa 35 vende secila; ▪ Kati tretë: 3 laboratorë, 8 zyra, 8 klasa 35 vende secila, 1 kalsë kapacitet 60 vende ▪ Kati katërt: salle leksionesh r 1 220 vende, salle leksionesh nr 2 80 vende, 1 laborator ▪ Kati pestë: 3 laboratorë, 1 zyrë. - Godina e Lendeve Paraklinike nr.2: Salle leksionesh nr1 175 vende, salle leksionesh nr2 180 vende, 5 laboratorë, 2 klasa 24 vende secila, 9 zyra. |
| Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | |
| Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | |
| Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | |
| Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, | Fakulteti i Mjekësisë ka në dispozicion të programeve të studimit laboratorët (mësimorë) si më poshtë: 1. Laboratori i Fiziologjisë |

| | |
|--|--|
| <p>diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p> | <ol style="list-style-type: none"> 2. Laboratori i Kirurgjise 3. Laboratori i Mikrobiologjisë, 4. Laboratori i Biokimisë, 5. Laboratori i Anatomisë Normale 6. Laboratori i Anatomisë Patologjike 7. Laboratori i Histologjisë 8. Laboratori i Farmakologjisë 9. Laboratori i Simulimit Klinik (ende jo ne funksion) 10. Laboratori i Komunikimit Mjekësor 11. Laboratori Mikrokirurgjisë Eksperimentale 12. Laboratori Informatik, Laboratori i Analizës së Drogave 13. Laboratori i Përgatitjes Galenike, 14. Laboratori i Përgatitjeve Kozmetike 15. Laboratori i Kimisë Toksikologjike 16. Laboratori i Analizës Farmaceutike 17. Laboratori i Kimisë Analitike 18. Laboratori i Kimisë Inorganike 19. Laboratori i Kimisë Organike 20. Laboratori Kërkimor Shkencor 21. 4 preparatorë <p>Gjithashtu në ambientet e spitaleve universitare, në dispozicion të procesit mësimor janë ambientet e dedikuara për programin e studimit mjekësi e përgjithëshme konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Spitali Francez, Salla ORL 130 vende, 1 zyre për departamentin ▪ Spitali nr.1, Salla e leksioneve 100 vende, 8 klasa 30 vende secila, 4 zyra ▪ Godina e Infektivit, Salla e leksioneve 130 vende ▪ Godina e Mjekut të Familjes 2 klasa 20 vende secila, 2 zyra ▪ Salla e Kirurgjisë 150 vende ▪ Spitali Universitar i Traumës (ushtaraku): 1 salle leksionesh 40 vende ▪ Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Nena Geraldine”, 1 salle leksionesh 170 vende, 1 klase seminaresh 20 vende ▪ Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, 1 salle leksionesh 80 vende, 2 klasa seminaresh 20 vende secila. <p>Godina qendrore e FM janë të vendosur autoritetet drejtuese te Fakultetit të Mjekësisë, sekretaria mësimore në funksion të programit të studimit, si personeli administrative ndihmës akademik dhe financiar i fakultetit.</p> <p>Gjithashtu në infrastrukturën në dispozicion të FM gjenden ambientet e zyrave të stafit akademik, të përgjegjësve të departamenteve, sekretarive mësimore etj.</p> <p>Perveç sa me lart, FM ka në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve për zhvillimin e procesit mësimor, kërkimor-shkencor spitalor e klinik, jo vetëm salat e dedikuara për mësimin (shih më lart) por të gjitha asetet e strukturave shëndetësore universitare, që në totalin e tyre janë rreth</p> |
| <p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p> | |
| <p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p> | |
| <p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p> | |

| | |
|--|---|
| | <p>115,500 m2. [Ev.50]</p> <p>Sallat janë të ndërtuara me standarte bashkëkohore, të pajisura me projektor, sistem kompjuterik, mikrofon për realizimin në kushte komode të leksioneve me studentët.</p> <p>UMT dhe FM kanë vënë në zbatim Sistemin e Menaxhimit (ESSE3) të ofruar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH). [Ev.51] Ky sistem përdoret nga personeli akademik dhe studentët në funksion të mësimdhënies ku shërbimi kryesor është ai i sekretarisë mësimore online dhe i menaxhimit të frekuentimit dhe provimeve. [Ev.52-54] Sistemi menaxhimit pasurohet vazhdimisht me module të reja, konkretisht për këtë vit është parashikuar futja e shërbimit të menaxhimit të burimeve njerëzore. Lidhur me përdorimin e këtij sistemi apo dhe platformave të tjera si Moodle, Ulibrary etj, janë organizuar trajnime me të gjithë aktorët. [Ev.57] Pozicionimi i sallave të leksioneve, dhe seminareve në një hartë të shtrirë mes FM, Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe qendrave spitalore të tjera të shpërndara në qytetin e Tiranës, krijon premiset e menaxhimit online të tyre e cila përmirëson planifikimin, dhe aksesin nga ana e studentëve.</p> <p>Kjo infrastrukturë e mjaftueshme dhe moderne në funksion të procesit të mësimdhënies për programin e studimeve të ciklit të dytë u përfshi nga një tërmet me një fuqi tepër të lartë për këtë rajon (magnitudë 6.5) pikërisht në periudhën që përkoi me periudhën para këtij vlerësim (26 Nëntor 2019). Këto pasoja kishin përfshirë edhe infrastrukturën e Universitetit Mjekësor, Tiranë. Gjatë vizitës në 20 – 21 Janar 2020, u verifikuan plan masat e Fakultetit të Mjekësisë për të siguruar një vazhdimësi normale të procesit mësimor nëpërmjet zhvendosjes së aktiviteteve mësimore në strukturat e padëmtuara dhe rishikimit të orarit me qëllim akomodimin e të gjithë aktiviteteve të planifikuara. Kjo përfshiu edhe shërbimin e laboratorëve të cilët ishin zhvendosur dhe ruajtur funksionaliteti për këtë qëllim.</p> <p>Universiteti i Mjekësisë ka disa biblioteka në shërbim të studentëve të cilat mund të frekuentohen nga studentët dhe personeli akademik, konkretisht: Biblioteka Qendrore, Biblioteka e FM, Biblioteka e FMD, Biblioteka e FSHMT, Telemedicina.</p> <p>Literatura bazë dhe ajo ndihmëse në funksion të programit të studimit të mjekësisë, u ofrohet studentëve në formën e teksteve mësimore bazë që gjenden në bibliotekën qendrore të UMT-së, dhe kryesisht në bibliotekën e FM [Ev.126] Ato gjenden në formë hard copy (2 deri 5 kopje për çdo titull) apo në formë elektronike në bibliotekat online ku kanë akses studentët e UMT-së, dhe specifikisht të mjekësisë së përgjithshme.</p> <p>Fakulteti i Mjekësisë ka bibliotekën e vet me rreth 30 vende studimi dhe një punjonjëse bibliotekë, dhe ku çdo student dhe personel akademik ka të drejtë për regjistrim falas. Fondi aktual i bibliotekës është fokusuar tërësisht në fushën e mjekësisë pasi botimet e tjera studentët i aksesojnë në bibliotekën e universitetit. Revista “Neë Bulletin of Medical Sciences” është botim zyrtar</p> |
|--|---|

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>i FM, numri i parë i të cilës daton nga viti 2007 dhe vazhdon aktualisht me dy numra çdo vit. Tashme kjo reviste del në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. [Ev.110] [Ev.146]</p> <p>Në arkivin e bibliotekës ruhen kopje të punimeve të diplomave të studentëve Master dhe Doktor i Shkencave. Ndërsa në fushën e mjekësisë botimet duhet të jenë të viteve te fundit (ku është përcaktuar një periudhë 5 vjeçare). Në rastet e pamundësisë së botimeve hardcopy, FM vë në dispozicion bibliotekën online me akses të plotë për studentët dhe personelin akademik.</p> <p>Ritmi i lartë i përditësimeve të botimeve, karakteristike e zhvillimeve në shkencat mjekësore e bën të pamundur furnimizim me të gjitha kopjet paper, për këtë arsye avancimet teknologjike janë një mënyrë efiçente që garanton disponibilitetin në kohë dhe me kosto të përballueshme për institucionin dhe studentët.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi III.4 | |
|---|--|
| Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është një institucion relativisht i ri duke qënë se strukturat e tij datojnë që nga viti 2013 (përpara kësaj date, ato ishin pjesë e Fakultetit të Mjekësisë, ngritur 1952). [Ev.8] Nga ana tjetër, eksperiencia e personelit akademik është e konsoliduar duke qënë se ky institucion si i vetmi universitet publik që prodhon pothuajse të gjithë të diplomuarit në Mjekësi të Përgjithshme. Akreditimi i vitit 2017 është një provë e cilësisë institucionale. [Ev.15] |
| Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron. | Në statutin e Universitetit Mjekësor, Tiranë, është përcaktuar si objektiv strategjik përmirësimi dhe sigurimi i cilësisë të proceseve të mësimdhënies si rezultat i të cilës është ngritur një sektor i posaçëm pranë UMT. NJSBC bazuar në rregullorenë saj bashkërendon dhe koordinon veprimtarinë mes strukturave të çdo fakulteti. [Ev.1] [Ev.4] [Ev.10-12]. GVJ konstatoi se NJSBC ka plane pune të miratuara që përfshijnë indikatorë dhe burime të dedikuara me qëllim zbatimit të procedurave të posaçme, ndarjen e eksperiencës dhe dokumentimin e saj etj. |
| Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | Në statutin dhe rregullorenë e UMT dhe FM, njësitë kryesore dhe ato bazë janë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në programin e studimit. Disa nga proceset e cilësisë të cilave iu është kushtuar një vëmendje e vecante janë: mësimdhënia në klasë, diskutimet në seminare dhe praktika klinike, hulumtimet në projekte individuale/në ekip, supervizim, tutorship etj. |
| Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p> | <p>Detyrimi i personelit akademik në ngritjen dhe ruajtjen e cilësisë aktualisht konsiderohet pervecse nje detyrim moral, dhe detyrim formal nepermjet mekanizmave vlerësimit të performancës akademike dhe rrjedhimisht në avancimin e akarrierës akademike të personelit.</p> | | | |
| <p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> | <p>Njësitë bazë (departamentet) në funksion t rolit t tyre bazë krijojnë një “dialog” të vazhdueshem per cilësinë e zbatuar në aktivitetet e mësimdhënies. Kjo realizohet nepermjet proceseve te cilat jane:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ rregulloret dhe dokumentave strategjike në çdo nivel; ▪ monitorimi dhe menaxhimi i tyre në mënyrë ciklike dhe ndarja e rezultateve pozitive mes njësive kryesore dhe atyre bazë; ▪ të disponojë burime njerëzore dhe financiare të dedikuara; ▪ të mbështesë iniciativa dhe projekte bashkëpunimi me qëllim sjelljen e përvojave dhe praktikave më të mira nga institucione të tjera të arsimit të lartë. | | | |
| <p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie analizojnë efektet e pritsmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p> | <p>Nga ana tjetër, rinovimi i pashmangshëm dhe vital i personelit akademik ka motivuar aktivete të përbashkëta me qëllim përmirësimin e aftësive dhe rezultateve të mësimdhënies duke organizuar periodikisht leksione dhe aktivite qe promovojnë diskutime dhe shkëmbime eksperiencash mes personelit të përvojë edhe atij të ri. [Ev.82, 113] [Ev.115]</p> | | | |
| <p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p> | <p>Eksperiencat nderkombetare ne funksion te cilesise te proceseve akademike, shkembihen ne kuader mobilitetit të personelit akademik, nepermjet aktiviteve të UMT me universitete partnere, në marrjen dhe prezantimin e eksperiencave cilësore të cilat aplikohen ne kontekstin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. [Ev.34]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | X |

| <p>Standardi III.5 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p> | |
|---|---|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> | <p>Programi i studimit të integruar i ciklit të dytë të studimit Mastër i Shkencave në Mjekësi të Përgjithshme, ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë dhe si çdo program i këtij fakulteti ka të përcaktuar të gjitha veprimtaritë formuese dhe format e vlerësimit të njohurive. [Ev.58] Në rregulloren e programit të studimit, në dosjen e programit të studimit, në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe në procedurat e tjera për mbarëvajtjen e procesit mësimor, janë të përcaktuara qartë të gjitha aspektet që lidhen me organizimin, zhvillimin dhe vlerësimin e studentëve. [Ev.66] [Ev.61-69]</p> <p>Studentët informohen në fillim të çdo lende për mënyrën e vlerësimit dhe testitmit final të saj. Bazuar në parime të përgjithshme, dhe pjesë e aftësive</p> |
| <p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lende/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i</p> | |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>lëndës/modulit.</p> <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p> | <p>pedagogjike të kërkuara për cdo personel akademik, studentët e këtij programi studimi vlerësohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit formues si dhe në fund të këtij procesi nëpërmjet provimit final të lëndës/modulit. Format e testimit të njohurive dhe aftësive të transmetuara gjatë zhvillimit të lëndës realizohet nëpërmjet aktivizimit në seminare, praktika, diskutime, pjesëmarrje dhe dorëzim detyrash individuale/ekip, testime të pjesëshme dhe provimi final.</p> <p>Në përputhje me rregulloren e programit të studimit, shpallen datat e provimeve të cilat pasi miratohen në dekanat saktësojnë datën, orën dhe sallën ku do të zhvillohen. Rezultatet shpallen në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në rregullore. [Ev.58] [Ev.61] Studenti ka të drejtën e katër sezoneve për të dhënë secili provim. Gjithashtu, studenti ka të drejtën e apelimit si dhe të përmirësimit të deri dy provimesh çdo vit akademik. [Ev.54] Në përfundim të provimit, pedagogu i lëndës përpilon rezultatet me të cilat studenti njihet paraprakisht në formë individuale nëpërmjet platformës ESSE3. [Ev.51]</p> <p>Aktivitetet sociale që zhvillohen me studenët që pas regjistrimit në vitin e parë ka një qëllim të dyfishtë: socializimin e tyre dhe përdorimin e këtij rrjeti për informimin e studentëve për çështjet më të rëndësishme që lidhen me statusin e ri.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ceremonia “dita e bluzave të bardha” vlen për studenët e vitit të parë në të cilën organizohet pritja e tyre me simbolikën e veshjes për herë të parë të bluzës së bardhë në statusin e ardhshëm të mjekut; 2. Vizita e ambienteve të Fakultetit të Mjekësisë nën organizimin e studentëve të viteve më të larta me qëllim njohjen e ambienteve dhe informimin e modaliteteve të aksesit të tyre. 3. Java e informimit të studentëve – për ata të vitit të parë zhvillohet në fillimin e çdo viti akademik në të cilin ju bëhet një përshkrim i shkurtër i programit, informacion për infrastrukturën në dispozicion, bibliotekën si dhe shërbimet e tjera. [Ev.90] 4. Dita e Ekselencës që organizohet me studentët më të mrië të FM nga ana e Njësisë Pedagogjike dhe Këshillimit të Karrierës | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | X |

| <p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p> | |
|--|--|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në</p> | <p>Testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale/klinike realizohen gjatë gjithë vitit duke u vlerësuar me pike nëpërmjet seminareve projekteve ose testimeve të ndërmjetme të përcaktuara dhe miratuara në syllabysin e</p> |

| | |
|---|---|
| vlerësimin përfundimtar. | lendes duke kontribuar në vlerësimin final të saj. |
| Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimiit dhe vlerësimiit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Programi i studimi ka profil te theksuar profesional dhe vlerësimi i studentit pëveç njohurive, bazohet dhe ne aftësitë profesionale. Testimet elektronike ofrojnë avantazhin e transparencës se njohurive dhe elememinimit të formave të ndryshme të abuzimit. Por, është pikërisht niveli i njohurive që paraqet edhe limitin e këtyre formave për shkak të rëndësisë që kanë objektivat e formimit të përfshijnë edhe rritjen praktikave profesionale nga ana e studentëve. Për të tejkaluar këtë kufizim, është në process instalimi dhe përdorimi i një platforme interaktive për rritjen dhe testimin e njohurive dhe aftësive nëpërmjet qendrës së simulimit klinik. Ky është një projekt bashkëpunimi mes Universitetin e Mjekësisë, Tiranë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. [Ev.29] |
| Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimiit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | Testimet dhe provimet e parashikuara për lëndët/modulet e programit të studimit zhvillohen gjithmë me komisione provimi. [Ev.58] [Ev.61] [Ev.66] |
| Kriteri 4. Testimi i vlerësimiit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie. | Njesia bazë, në bashkëpunim me dekanatin, harton dhe shpall publikisht kalendarin e provimeve. Titullari i lëndës, në përputhje me kalendarin e shpallur, me fletët e provimit të përgatitura nga sekretaria mësimore (firmosur dhe vulosur nga zv.dekani), bashkë me fotokopjet e tezave të provimit, të miratuara paraprakisht nga drejtuesi i njësisë bazë, bën verifikimin e studentëve dhe zhvillon procesin e provimit. |
| Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente /feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Sekretaria mësimore, në bashkëpunim me sekretarine e departamentit, realizon procesin e sekretimit të vlerësimiit, me qellim ruajtjen e anonimatit të studentit gjate provimit dhe vlerësimin transparent. Pedagogu korrigjon dhe më pas sekretaria mësimore, shpall rezultatet brenda afateve kohore të paracaktuara. Shpallja nenkupton procesin ku studenti ka akses ne rezultatet personale te provimit, duke ruajtuar konfidencialitetin e të dhenave. Studenti mund të marrë rezultatin në ditën përkatëse të caktuar nga pedagogu, duke u loguar personalisht ne sistemin e menaxhimit te te dhenave. [Ev.51] Nëpërmjet këtij sistemi, menaxhohen dhe aksesohen të dhënat e rezultateve te studentdve [Ev.54]. Studenti ka te drejten e apelimit, proces i cili parashikohet dhe pdrcktohet ne rregullore. |
| Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Procesi mbyllet me dorëzimin e fletes së notave në sekretari, si dhe dorëzimin e kopjes se tezës së provimit bashkë me çelësin e zgjidhjeve pranë departamentit. Pedagogu parashikohet të mbajë një fotokopje të procesverbalit të provimit që ka dorezuar, ndërsa studenti ka të drejtën e ankimit të notës. [Ev.148] |
| Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Komisionet e provimeve përcaktohen nga Departamentit ne bashkepunim me Zv. Dekanin per anen mësimore dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Provimet realizohen sekretim kur ato zhvillohen me shkrim. Mjediset ku zhvillohen provimet janë të monitoruara me sistem qendror kamerash si edhe me personel shërbimi qe ka si detyre kryesore ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë për zhvillimin normal të procesit të provimeve [Ev.72]. [Ev.124]. |
| Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimiit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimiit. | |
| Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimiit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet | |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | Qëllimi final i rregullores së provimit synon në vlerësimin e studentit në përputhje me objektivat e formimit që synon çdo lende/modul. Së dyti, standardizimi dhe transparenca janë dy elementë të meritokracisë që studenti duhet të konstatojë si dhe mekanizmat e ankimimit në raste të veçanta. Këto aspekte duken të vlerësuara dhe të rregulluara në dokumentat e paraqitura. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi III.7 | |
|---|---|
| Programi i integruar i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Permbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në Mjekësi e Përgjithshme garanton thellimin e njohurive të studenteve dhe zhvillimin e aftësive profesionale të tyre. Kjo kurrikul është organizuar në 6 vite akademike, ka 42 lende/67 module ku studenti thellon njohuritë në fushën e mjekësisë. [Ev.61-62] |
| Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Raportet midis veprimtarive formuese dhe formave të mësimdhënies janë organizuar në mënyrë të tillë që të garantojnë thellimin e njohurive, të zhvillojnë aftësitë e thelluara profesionale të studentëve si dhe të pajisin ata për tregun e punës dhe/ose për ciklin e trete të studimeve [Ev.64] |
| Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. | Për të zhvilluar më tej aftësitë e përdorimit të teknologjisë programi ka në përmbajtje module të formimit të përgjithshëm, teknologjisë dhe zbatimit të saj në mjekësi, etikës profesionale dhe komunikimit, administrimit të pacientit etj [Ev.62] |
| Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, stafi akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar. | Syllabuset e lëndës/modulit parqesin përmbajtjen e saj, dhe ndarjen sipas veprimtarive formuese, kreditet dhe orët përkatëse. Objektivat aftësitë dhe kompetencat janë paraqitur jo vetëm në përmbajtje të programit të studimit [Ev.61] por në çdo syllabus. [Ev.64] |
| Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Në javën e fundit të zhvillimit të lëndës studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final. |
| Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Personeli akademik i brendshëm integron të rejtat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që ju jepet studentëve gjatë orarit normal të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij kur është e nevojshme. Departamenti dhe fakulteti vazhdimisht organizojnë leksione dhe seminare të hapura në funksion edhe të edukimit në vazhdim [Ev.82] [Ev.113-115]. |
| Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e | Ndërsa pjesa e përket përgatitjes profesionale dhe zhvillimit të |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| problemeve/çështjeve të caktuara. | kompetencave të studentëve, FM dhe të gjitha strukturat spitalore me të cilat bashkëpunon dhe bashkërendon punën e vet, ofrojnë ndaj studentëve të gjithë infrastrukturen e nevojshme për realizimin e praktikave veçanërisht trajnimet dhe praktikimi me paciente që trajtohen në këto klinika, psh në semiologji, kirurgji etj. | | | |
| Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet. | Falë eksperiencës shumë vjeçare të personelit akademik edhe në ofrimin e shërbimeve klinike, mjaft studente bashkëpunojnë me pedagogët e FM për çështje të caktuara si për shembull puna si observues dhe ndihmes në sallat e kirurgjise së përgjithshme. | | | |
| Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | FM ka krijuar një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative dhe kërkimore në bashkëpunim me studentët. Shumë raste stafi akademik publikon, referon apo prezanton rezultatet e kërkimeve shkencore. [Ev.111-112] Gjithashtu nëpërmjet partneritetit me spitalet universitare në vend, ka krijuar mundësinë e mbështetjes së studentëve tane për kërkimin shkencor në një format më të lidhur me klinikën. | | | |
| Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve | Edhe financiarisht janë gjetur mundësi mbështetjeje për studentët si për shembull vizita të zhvilluar në Zagreb, Frangurt etj falë mbështetjes së projekteve të ndryshme. [Ev.128] | | | |
| | UMT-ja, gjithashtu, ka arritur të integrojë në fushën kërkimore dhe shkencore jo vetëm stafin, por edhe studentët, duke i stimuluar për të organizuar dhe realizuar konferencat e tyre. Konkretisht janë realizuar Konferenca Mjekësore të Studentëve, në bashkëpunim me këshillat studentorë, urdhrat profesional, shoqata profesionistësh si dhe në bashkëpunim me universitete të tjera publike dhe jopublike. [Ev.115] | | | |
| | Marrëveshjet e firmosura me institucione arsimore dhe joarsimore (në total janë 52 marrëveshje në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar) krijojnë dinamike bashkëpunimi të cilat mund të krijojnë oportunitete të interesit të ndërsjellët në fushën e kërkimit shkencor. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | |
|--|---|
| Standardi III.8 | |
| Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Në nivel institucional, aktet rregullatore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe të Fakultetit të Mjekësisë, kanë parashikuar në mënyrë të detajuar procesin e diplomimit të studentëve në tërësi dhe ata të ciklit të dytë të studimeve. [Ev.3] [Ev.5] Për programin e mjekësisë së përgjithshme është hartuar dhe rregullorja |

| | |
|--|--|
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> | <p>specifike e punimit të diplomës në të cilën janë përshkruar qartë procedurat, formatet, modalitetet e mbrojtjes së diplomes [Ev.73]</p> <p>Ne programin e studimit MSc. Mjekësi e Përgjithshme, sikundër është përmendur edhe më lart, është detyrim ligjor LAL 80/2015 përmbyllja e ciklit të studimeve master me punim diplome. Punimi i diplomës është një punim i pavarur shkencor i studentit. Procesi nis nga fakulteti i cili miraton listen e studenteve dhe udhëheqësit shkencorë të cilet do të jenë mbikqyresit e studenteve deri në mbrojtjen finale të temës së diplomës. [Ev.104]</p> |
| <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> | <p>Udhëheqësi i puniit të diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përaferta të realizimit të tij. [Ev.74] Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre dhe nxjerrjen e konkluzioneve. Nëse ato janë në përputhje me rezultatet e pritshme, udhëheqësi jep udhëzimet e nevojshme dhe orienton studentin për zhvillimin e mëtejshëm të diplomës. [Ev.73]</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p> | <p>Në rastet kur punimet e diplomave të studentëve janë konsideruar të suksesshme dhe të vlerësuara maksimalisht nga komisioni i diplomimit, u është dhënë mundësia e prezantimit të rezultateve në evente të ndryshme që fakulteti organizon ose punimi botohet në revistat shkencore të fakultetit. [Ev.110-111]</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> | <p>Udhëheqësi shkencor i miratuar planifikon një kalendar komunikimi me studentin në lidhje me mbarëvajtjen e punës për realizimin e punimit. Format e komunikimit janë përmes email-it ose takime të përcaktuara në mjediset e Fakultetit.</p> |
| <p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> | <p>Në përfundim të mbrojtjes së diplomes, studenti vlerësohet me notë e cila pasqyrohet në procesverbalin perkates dhe depozitohet në sekretarinë mësimore. [Ev.105]</p> |
| <p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë</p> | <p>Studenti dorëzon në sekretarinë e fakultetit diplomën e shkruar, kopjen elektronike të saj e cila arkivohet dhe depozitohet në bibliotekën e fakultetit.</p> |
| <p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> | <p>Në statutin e UMT janë përcaktuar modalitetet e diplomimit, pajisjes me diplome dhe suplemente diplome të të gjithë studentëve që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademik edhe administrative ndaj institucionit. [Ev.67-68] UMT-ja, çdo vit akademik realizon në nivel universiteti Ceremoninë e diplomimit. Diploma është dokument unik që mban të gjithë elementet e përcaktuara dhe miratuar me udhëzimin perkates të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Fakulteti pajis studentin në përfundim të detyrimeve akademike, me diplomën dhe suplemente diplome. [Ev.67-68]</p> |
| <p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> | <p>Prej vitit 2019, me ndihmen e projektit GRADUA [Ev.96] çdo student para pajisjes me diplome, regjistrohet në databazën e krijuar posaçërisht nga ky projekt dhe që u mundëson ndjekjen në kohë reale të studentit dhe punësimit të tij. Listimi në këtë databazë e ndihmon atë të jetë pjesë e listave të të diplomuarave në nivel evropian çka u mundëson akses më të lehtë në tregun e</p> |
| <p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të përcaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen</p> | |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>punës.</p> <p>Studentit i vihet në dispozicion kopje e plote zyrtare e programit të studimit të zhvilluar [Ev.61] ne rastet kur ai e kërkon. Dokumentacioni për studentët ruhet në fakultet në hardcopy si dhe në databazën digitale që tashmë disponojnë njësitë kryesore të UMT, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arkivat [Ev.51] [Ev.109] [Ev.131]</p> <p>Mbështetur në këto akte dhe legjislacionin në fuqi, dokumentacioni themelor për studentët është:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistri themeltar i studentit i cili vërteton regjistrimin e studentit që pajisjet me numërmatrikulimi dhe në marrjen e diplomës ose certifikatës, 2. Regjistri i arritjeve akademike të studentit që vërteton rezultatet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik, 3. Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave që vërtetojnë emetimin e diplomave dhe certifikatave. <p>Keto dokumente si dhe procesverbalet e provimeve, ruhen, pas diplomimit, në arkiven e institucionit dhe më pas dorëzohen në Arkivën Shtetit Shqiptar. Të dhënat origjinale të studentit i kthehen ndërsa institucioni ruan kopje të njesuar me origjinalin në formë hardcopy dhe elektronike [Ev.100]</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| | |
|---|---|
| Standardi IV.1 | |
| Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit | <p>Stafi akademik, stafi administrativ dhe personeli ndihmës janë të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme në përputhje me statutin dhe rregulloren UMT (1, 3, 35).</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, çdo departament identifikon nevojën e personelit bazuar në kërkesat e mësimdhënies: këto verifikohen më tej nga Fakulteti i cili i dërgon ato për miratim në Rektorat në përputhje me neni</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p> | <p>65 të statutit UMT.</p> <p>Vendet e lira të punës shpallen në faqen zyrtare të UMT në përputhje me kriteret dhe kuadrin ligjor në fuqi (Ev.35). Kriteret specifike përcaktohen nga departamenti të cilat kanë lidhje me lëndën që duhet të mbulojë kandidati në këtë program studimi.</p> | | | |
| <p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p> | <p>Dokumentet e nevojshme për secilën dosje të kandidatit shpallen në momentin që dalin edhe kriteret. Ato duhet të dorëzohen me postë ose personalisht.</p> <p>Për të përzgjedhur dhe intervistuar kandidatët bgrihet një grup pune i përbërë nga 5 anëtarë (3 përfaqësues nga departamenti, 1 përfaqësues nga dekanati dhe 1 përfaqësues nga Rektorati Vendimarrja e grupit të punës mbi procesin e rekrutimit komunikohet përmes Burimeve Njerëzore. Kandidatët renditen në bazë të 12 kriterëve dhe njoftohen për renditjen e tyre (Evt 35). Kandidatët kanë 3 ditë për të apeluar dhe UMT ka dy ditë për të kthyer përgjigje. Pas përfundimit të kësaj procedure, renditja dhe lista e kandidatëve të përzgjedhur i dërgohet Rektoratit. Pas verifikimeve të mëtejshme, kandidata tëve që kanë fituar, ju dërgohet punësimit e cila nënshkruhet brenda 30 ditëve (Evt 35, 79, 143-144).</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> | <p>Procedurat janë të mirëpërcaktuara dhe transparente, të ngjashme me institucionet e tjera akademike ndërkombëtare. Ato garantojnë konkurrencë dhe rekrutim të drejtë. Të gjitha dokumentet janë ruajtur në Zyrën e Burimeve Njerëzore.</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p> | <p>Ndërkohë në bazë të aktivitetit personal, dosjet e personelit përditësohen vazhdimisht me aktivitete të reja të stafit, rezultate të kërkimit apo botime shkencore. Pjesë e dosjes individuale janë edhe vlerësimet e kryera nga institucioni, apo penalitete të ndryshme të dhëna nga institucioni në vite.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Niveli i përmbushjes</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p> | <p>UMT ka në strategjinë zhvillimit të tij politika të qarta për krijimin mundësive të barabarta e të përshtatshme për kryerjen sa më optimale të detyrave akademike. UMT qartazi ka siguruar një infrastrukturë të bollshme për personelin akademik falë partneritetit me strukturat shëndetësore universitare si për procesin mësimdhënies ashtu edhe për kërkimin shkencor dhe ushtrimin e profesionit. [Ev.17]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe</p> | |

| | |
|---|--|
| <p>zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p> | <p>Strukturat kryesore spitalore universitare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë. • Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Nena Geraldine” • Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Koco Gliozheni”. • Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë. • Spitali Universitar i Traumës, Tiranë. • Klinika Stomatologjike Universitare. <p>dhe me të cilat UMT kanë bashkëpunim të ngushtë dhe rregullojnë veprimtarinë e tyre në fushën e edukimi tdh ekërkimit me VKM: Po ashtu, struktura të tjera pjesë e sistemit shëndetësor universitar janë Instituti i Shëndetit Publik dhe Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.</p> <p>Kualifikimi dhe zhvillimi profesional i stafit të UMT-së me qellim përvetësimin e praktikave me të mira akademike dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare, konsiston ne disa drejtime:</p> <p>Ofrimin e leksioneve te hapura me lektore te huaj dhe personalitete te fushave mjekësore specifike, Ofrimin e trajnimeve nga shërbimet spitalore lidhur me metodat inovative ne specialitetet përkatëse, Ofrimin e edukimit ne vazhdim falas për te gjithë stafin etj. [Ev.50].</p> <p>Në zbatim të strategjisë te UMT-se lidhur me metodat inovative të mësimdhënies për shkak të dinamikës se shpejtë të zhvillimit teknologjik në fushat e mjekësisë janë integruar një sërë metodash inovative brenda mundësive financiare qe siguron institucioni. Një projekt konkret ambicioz lidhur me futjen e teknologjive te reja ne procesin e mësimdhënies ishte ngritja e qendrës se simulimit klinik për te cilën eshte aplikuar ne disa burime te mundshme financiare si ambasada të akredituara në Shqipëri, organizata ndërkombëtare etj. [Ev.151]</p> <p>Në funksion të programit të studimit Msc Mjekësi e përgjithshme, fakulteti angazhohet plotësisht për të realizuar objektivat e programit të studimit duke i venë në dispozicion të jo vetëm të këtij programi por edhe të të gjithë programeve të tjera që ofron, kapacitetet akademike dhe ndihmës akademike dhe infrastrukture.</p> <p>Njësia bazë përgjegjës për programin e studimit menaxhon dhe drejton në përputhje me kuadrin ligjor ne fuqi si dhe me aktet rregullative menaxhimin e stafit akademik dhe stafit ndihmës duke ndare përgjegjësitë dhe detyrat në mënyre sa me optimale.</p> <p>Njësia baze angazhohet qe stafi akademik të plotësoje detyrimet ligjore ne lidhje me ngarkesën mësimore, institucionale dhe atë kërkimore duke mbledhur ne fillim te çdo viti akademik parashikimin e orëve te punës për secilin veprimtari dhe ne fund te çdo viti akademik formularin e realizimit te detyrimeve ligjore dhe detyrave te përcaktuara shtese. Departamenti te dhënat e mbledhura i bën pjesë te raporti vjetor me analizën përkatëse si dhe me plan masat përkatëse. [Ev.84].</p> <p>Në diskutim me stafin që u përfshinë me sukses në programet e</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor.</p> | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të integruar të studimeve</p> | |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | shkëmbimit H02020 dhe Erasmus, u evidentua nevoja për të mbështetur stafin akademik në përgatitjen e buxhetit dhe aplikimin e granteve. Në këtë drejtim duhet të vazhdojë fuqizimi i zyrës për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe projektet në UMT. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | UMT zhvillon veprimtari mësimore në pesë ndërtesa kryesore, shumica e të cilave operojnë në disa ndërtesa specifike, të gjitha së bashku duke përfshijrë 105.038 m ² siç përshkruhet në detaje në [Evt 50 dhe 90]. Hapësira mësimore përbëhet nga zyra, si dhe klasa leksioni dhe seminare, hapësira laboratorike, të cilat janë konform me kërkesat shëndetësore, sigurisë dhe ngrohjes. Hapësira mësimore është lehtësisht e arritshme nga studentët dhe stafi dhe ambientet mbrohen nga zhurmat e jashtme, duke u mundësuar të gjithëve të përqëndrohen në aktivitete mësimore. |
| Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Bashkëpunimet me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH) sigurojnë trajnime mbi metodat e bioinformatikës dhe shkëmbimin e informacionit cilat së bashku me laboratorët elektronikë të pajisur mirë dhe sigurojnë standarde të larta të mësimin për studentët e mjekësisë. Ne patëm mundësinë për të vizituar disa hapësira të përdorura për ligjërata dhe praktika laboratorike. Ata ishin të pajisura shumë mirë me pajisjet e fundit të IT ose laboratorit. Pavarisht tërmetit të fundit dhe dëmet që ai shkaktoi në disa ndërtesa të UMT, u bënë përpjekje maksimale për të vazhduar mësimin duke përshtatur lehtësira shtesë dhe duke zgjatur orët e mësimin. |
| Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Projekti i ri i laboratorit i simulimit klinik, i cili është duke u zhvilluar, do të sigurojë një bazë të shkëlqyer mësimore për studentët e mjekësisë. GVJ konstaton se sipërfaqet që përdoren nga personelit akademik dhe studentët për kryerjen e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, janë në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe kuadrin ligjor në fuqi UMT për shkak të statusit që ka në fushën e edukimit shëndetësor si dhe falë bashkëpunimit me QSUT dhe me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), garanton mjediset të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. |
| Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Stafi i UMT ka funksion të dysishtë akademik, kërkimor dhe në shërbimin |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p> | <p>spitalor terciar. Kjo ndihmon që programi i studimit të ketë në dispozicion të gjitha laboratorët ku zhvillohen orët laboratorike. Personeli dhe studentët në këto struktura, kanë në dispozicion infrastrukturën e duhur për kryerjen e praktikave profesionale dhe veprimtaritë e tjera.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

| <p>Standardi IV.4</p> | |
|--|---|
| <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> | <p>UMT ka një bibliotekë të mirëpajisur, që përmban 170 libra shkollorë mjekësorë dhe një numër në rritje të artikujve shkencorë shqiptarë dhe të huaj dhuruar nga mjekë të njohur shqiptarë ose bashkëpunim me shkolla të tjera mjekësore. Biblioteka është mjaft e frekuentuar nga studentët në orarin zyrtar të reklamuar paraprakisht, sidomos gjatë periudhës së provimeve.</p> |
| <p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> | <p>Biblioteka ka 39 kompjuterë, që mundësojnë kërkime elektronike dhe qasje në artikuj dhe libra të ndryshëm. [Evt 126]. Fondi i përgjithshëm i libra arrin 53,000 libra dhe rreth 18,000 revista shkencore. Të gjitha tezat e doktoraturës depozitohen gjithashtu në bibliotekë dhe ruhen në mënyrë elektronike, duke mundësuar kështu qasje të lehtë për të gjithë ata që mund të jenë të interesuar.</p> <p>E gjithë literatura e nevojshme për programin MSc është në dispozicion në bibliotekë, duke lehtësuar qasjen e studentëve në materialin e kursit. Përveç bibliotekës në ndërtesën kryesore të Universitetit, në tre fakultetet e UMT ka edhe bibliotekat e tjera, të cilat ndjekin të njëjtat parime pune si biblioteka kryesore.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p> | <p>UMT ka një grup kolegjal që diskuton dhe aprovon botimin e materialit akademik dhe mësimor të personelit, si dhe artikujt në revistën shkencore të UMT, e cila botohet në anglisht dy herë në vit. Stafit akademik mund të botojë në këtë revistë falas (Evt 19).</p> |
| <p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> | <p>Nga biseda me studentët u theksua që biblioteka ka orare të përshtatshme për studentët. Ata kishin mundësi ta aksesonin edhe ditën e shtunë në periudhën e provimeve.</p> |

| | | | | |
|---|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | UMT disponon edhe 3 bibliotekat në fakultete të cilat janë nën varësinë e bibliotekës qendrore. Ato kanë literaturë mësimore bazë dhe ndihmëse, si dhe literaturë shkencore të fushave përkatëse sipas fakultetit. | | | |
| Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj | Literatura e depozituar në bibliotekën e Fakultetit të Mjekësisë duke i krijuar mundësi studenteve të studiojnë dhe të përdorin literaturën pranë bibliotekës. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | UMT përdor një sistem elektronik efikas (ESSE3), i cili mbulon shumë aspekte duke përfshirë të dhënat e studentëve, provimet, mësimdhënien dhe menaxhimin financiar [Evt 53]. Në këtë sistem ruhen të dhëna në kohë reale mbi strukturën akademike, përparimin e stafit dhe kualifikimet e tyre, pjesëmarrjen e studentëve në leksione. Gjithashtu të dhënat e stafit akademik hidhen e në sistemin AMS të ASCAL, të dhëna këto përditësohen në kohë reale dhe lehtësojnë punën midis institucioneve. |
| Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Kopjet fizike mirëmbahen dhe arkivohen si një rezervë, e cila siguron ruajtjen e të dhënave në mënyrën e duhur. Materialet kryesore (për shembull dokumentet e diplomësruhen në sekretari, duke siguruar një kopje tjetër të pavarur të dokumentacionit të rëndësishëm. UMT publikon informacione mbi aktivitetet e ditës, detyrat e personelit, detyrat e studentëve, diplomimin dhe transferimet e kursit [EVT 58]. Rrugët e tjera të komunikimit janë përmes faqes së internetit (ajmhs.umed.edu.a), postave elektronike dhe mediave sociale [Evt 134, 135]. Stafi dhe studentët janë të trajnuar në përdorimin e pajisjeve dhe kanë të gjitha lehtësitat për t'i përdorur këto për aktivitetet e tyre të përditshme [Evt 125]. Informacioni publikohet gjithashtu në zyrat kryesore (sekretaritë për shembull) të cilat frekuentohen në mënyrë të vazhdueshme nga studentët dhe stafi, duke bërë të mundur rritjen e vizibilitetit të saj. |
| Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Gjatë vizitës, u evidentua qartë se stafi administrativ dhe stafi ndihmës ishin me përvojë shumë të mirë dhe mëpërvojë pune të gjatë në UMT. Kjo krijon |
| Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të | |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | një mjedis të shkëlqyeshëm pune, ku stafi administrativ dhe menaxherial bëjnë çmos për të ndihmuar studentët dhe stafin për të arritur rezultatet e tyre më të larta. | | | |
| Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Përdorimi i teknologjisë aplikohet në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, shkëmbim informacioni dhe materiale me studentët | | | |
| Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe | Pjesa e teknologjisë është telemjekësia e cila shërben për ofrimin e shërbimeve mjekësore nëpërmjet teknologjisë për pacientin | | | |
| | Nga kjo platformë ofrohen shërbime trajnimi për studentët, specializantët, personelin mjekësor të strukturave spitalore etj. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | UMT merr grante nga buxheti i shtetit, nga të ardhurat e studentëve dhe projektet e tjera të financuara. Shpërndarja e buxhetit bëhet në përputhje me nevojat e secilit fakultet dhe departament: këto raporte përpilohen çdo vit dhe diskutohen në disa nivele, përfshirë Fakultetin dhe Rektoratin [Evt 149]. Këto fonde përdoren për të mbështetur funksionimin e UMT duke ruajtur shërbimet kryesore teknologjike dhe pasurimin e materialit mësimor [Evt 137, 138]. Zyra e financave mban shënime dhe raporte financiare me Ministrinë së Financave, ndërsa një grup i veçantë kryen veprimtarinë e auditimit dhe raporton tek Ministria e Financave, Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) [Evt 150]. |
| Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij. | Gjatë vizitës, u evidentua qartë se buxheti i marrë nga qeveria përdoret për të mbështetur pagat e stafit. Të ardhurat e përfituara nga tarifat e studentëve janë ulur për shkakë të paktit për universitetin, por falë këtij të fundit do të ndërtohet një kampus i ri universitar i cili do të jete sipas standardeve europiane. Edhe pse ky buxhet ka qënë i kufizuar IAL ka gjetur mënyra të tjera për të përmirësuar infrastrukturen përmes donacioneve dhe në një masë më të vogël, përmes buxheteve të financuara nga BE. Duke forcuar me tej zyrën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe punësimin e do të merren më shumë |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifata dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> | <p>projekte të financuara prej BE të cilat do të mundësojnë UMT të përmirësoj më tej infrastrukturën në funksion të stafi akademik dhe studentëve.</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> | <p>Bordi i administrimit është që mbikëqyr e kontrollon veprimtarinë e UMT që lidhet me menaxhimin financiar dhe të aseteve të tij. Administratori është drejtuesi i cili është pjesë e strukturave ekzekutive dhe përgjegjës për zbatimin e politikës financiare</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p> | <p>Në fund të çdo viti UMT dokumenton raportet financiare për vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| | |
|---|--|
| <p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të</p> | <p>Zgjedhja dhe pranimi i studentëve kryhet në përputhje me rregulloret e përcaktuara nga UMT (Evd 1 dhe 3). Kuota për pranimin e studentëve për çdo vit përcaktohet nga secili fakultet dhe aprovohet nga UMT. Këto kuota</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit",
 Nr. 219, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

| | |
|--|--|
| <p>studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> | <p>aprovohen më tej MASR dhe (Evd 40) publikohen</p> |
| <p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Cdo vit, UMT organizon një ditë të hapur për studentët e vitit të tretë dhe të 4-të të arsimit të mesëm, ku ata kanë mundësinë të ndjekin për një ditë të plotë një student të mjekësisë, duke u dhënë atyre një pasqyrë më të gjerë të profesionit të mjekut dhe arsimit në këtë universitet. Kriteret për pranimin e studentëve dhe vlerësimi e tyre publikohen përpara se të fillojnë aplikimet e kandidateve. [Evd 36, 37, 39, 41]. Vlerësimi bazohet në rezultatet e marra gjatë arsimit të mesëm, lëndët e zgjedhura, shkollën e ndjekur dhe provimet e vitit të fundit. Ky proces siguron barazi në vlerësimin e aplikantëve. Një grup i veçantë ngrihet për të shqyrtuar aplikimet (Evd 43). Lista e kandidatëve fitues dhe demografia e tërë procesit të aplikimit publikohet nga UMT. (Evd 43).</p> |
| <p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> | <p>Ne diskutuam gjatë vizitës, mundësinë e zhvillimit të një testi online për të vlerësuar aftësinë klinike për maturantët aplikuese (i ngjashëm me provimin në vende të tjera të BE). Kjo mund të pasohet me intervistat e drejtpërdrejta, të cilat do të mundësojnë përzgjedhjen e kandidatëve me arritjet më të larta, të cilët gjithashtu duhet të zotërojnë aftësitë e nevojshme komunikuese dhe humanitare edhe pse në këtë program studimi gjithmonë janë përzgjedhur maturantët e Republikës së Shqipërisë.</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e integruar të studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p> | <p>Në fillim të çdo viti organizohet një proces prezantimi me Universitetin [Ev 91], e cila quhet Dita e Bluzave të Bardha ku çdo student merr një veshje të bardhë mjeku nga UMT dhe pajiset me udhëzuesin e këtij fakulteti, ku studenti gjen të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me Institucionin që ka zgjedhur të studiojë (Evd 90). Studentët kanë mundësi të shumta për të marrë ndihmë/udhëzime, si nga zyrat e sekretarive (Evd 123-124) ashtu edhe nga aktivitetet e tjera që organizohen nga UMT në fillim të çdo viti akademik (Evd 120, 121). Ishte mbresëlënëse të dëgjoje nga studentët e rinj, se sa mbështeteshin nga te studentët më të vjetër (viti 4, 5 dhe 6) për këshilla, ndihmë apo edhe leksione. KSFM dhe stafi akademik / klinik së bashku me stafin administrativ, bëjnë një punë fantastike në ofrimin e programit të studimit, mbështetjes dhe këshillave për studentët. Kjo u evidentua qartë gjatë vizitës dhe bisedave me studentë nga të gjitha vitet.</p> |
| <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> | <p>Për momentin, kurrikula mësimore ofrohet vetëm në gjuhën shqipe. Mosfleksibiliteti financiar publik nuk mundëson hapsire për menaxhimin e tarifave e studentëve të huaj dhe pse në të gjitha aplikimet që u organizuan, doli qartë dëshira që kishtë UMT për tu ndërkombëtarizuar. UMT planifikon ta ndryshojë këtë së shpejti, duke filluar me ofrimin e lëndëve mësimore në anglisht përgjatë viteve të fundit. Bursat u ofrohen studentëve me nota të larta (9-10), për studentë në nevojë (Evd 127-130). Të gjitha këto informacione bëhen publike në faqen zyrtare të IAL.</p> |
| <p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> | <p>GVJ konstaton se: mundësitë për të tërhequr studentë ndërkombëtarë në UMT janë të mëdha. Stafi akademik dhe studentët që ndjekin aktualisht këtë program studimi kanë një nivel të lartë të gjuhës angleze. Fakt i cili u konstatua nga CV e stafit akademik. Aktualisht, studentët e shkëmbimit të Erasmus po zhvillojnë mësim në UMT, e cila ka kërkuar që komunikimet të zhvillohen në anglisht, veçanërisht gjatë kohës së seminarit. Ky është një</p> |
| <p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p> | |
| <p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë</p> | |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | shembull i shkëlqyeshuer ku sipas studentëve dhe stafit, nuk ka krijuar asnjë problem në komunikimet e përditshme apo realizimin e seminareve, pasi anglishtja është një gjuhë që zotërohet nga shumica e studentëve dhe stafit. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Studentët kanë ngritur Këshillim Studentor të tyre, të quajtur KSFM, i cili ka kontakte të rregullta me stafin akademik dhe transmeton kërkesat e studentëve tek ata (Evd 120-122). Dekani organizon takime miqësore studentët, duke mundësuar komunikimin të drejtpërdrejtë me ta dhe zgjidhjen e çështjeve apo problematikave të rëndësishme. Gjatë takimit me studentë na u tha se ata e vlerësonin shumë këtë pjesë dhe adresuar probleme tek dekani, ato gjithmonë kanë marrë zgjidhje nga studentët (Evd 120-122). Në disa raste, KSFM ka përcjellë kërkesat e studentëve për seminare shtesë në lëndë të veçanta, të cilat janë konsideruar dhe përmbushur nga stafi akademik. |
| Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Takimet midis stafit akademik dhe studentëve janë të shpeshta, ku ata njihen me procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme, vlerësimin gjatë kursit, diplomimin dhe mundësitë e punësimit. Të gjithë këto element përcatohen qartë në udhëzimet dhe rregulloret e UMT (Evd 66, 134, 135). |
| Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Me vendim dekanit është krijuar një zyra e karriere, të cilin ne patëm mundësinë për t'u takuar me ta dhe për të diskutua në lidhje me aktivitetin e tij. Ata organizojnë Ëorkshope të ndryshëm, të cilat ndihmojnë studentët gjatë përgatitjes së projekteve të tyre të vitit të fundit (diplomë), hartimin apo shkrimin e artikujve shkencor dhe prezantime të ndryshme që ju duhen studentëve kur janë pjesmarrës në konferenca. UMT është në proces të forcimit dhe punësimit të stafit të detikuar në këtë drejtim, duke bërë të mundur kështu rritjen e mëtejshme për studentët e këtij programi studimi. |
| Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Mediat sociale, komunikimet në çebfaqen e UMT, faqet personale të personelit akademik, si dhe posterat dhe reklamat e ndryshme përdoren për të informuar studentët për oraret dhe procedurat e mësimdhënies [Evd 101, 118, 123, 124, 90]. Gjithashtu IAL organizon edhe takime me studentet ku i ve në djeni të aktiviteteve që do të organizojë, mundësivë që kanë studentët për mabletitet apo për programe Erasmus. |
| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të | Faqa zyrtare e Intrenetit të UMT është gjithashtu burimi kryesor ku studentët mund të informohen për aktivitete të ndryshme dhe aktivitete kërkimore |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| ardhshëm mbi programin e studimit | <p>jashtëkurrikulare (Evd 134, 135).</p> <p>Përveç kurrikulës së detajuar (Evd 66), studentët këshillohen se si të përgatisin punën e tyre me tezen e diplomës nga stafi akademik (Evd 73).</p> <p>Gjithashtu edhe departamentet publikojnë informacione në lidhje me mënyrën e punimit të tezës së masterit duke përfshirë jo vetëm formatin e shkrimit por edhe udhëzime në lidhje me organizimin e përgjithshëm të saj [Ev.73]</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi V.3 | |
|--|--|
| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Programi mësimor është i organizuar në 6 vjet, ku secili vit përmban 60 kredite. UMT ofron një përshkrim të hollësishëm të kurrikulave mësimore (Evd 63), me përshkrim të hollësishëm dhe të detajuar të secilës lëndë që ka kursit (Evd 64). Shpërndarja e orëve mësimore, të laboratorit dhe praktikës klinike janë publikuar gjithashtu në faqen zyrtare të UMT dhe FM. (Evd 65). |
| Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Stafi akademik u vlerësua shumë nga studentët për sigurimin e teksteve shkollore, materialeve shtesë mësimore si dhe lidhjes me anë të postës elektronike, për ata që janë të interesuar për informacione shtesë. UMT vlerëson rregullisht cilësinë e librave dhe siguron që ato përditësohen në përputhje me zhvillimet e kohës në këtë fushë. |
| Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | UMT publikon pranimin, diplomimin, procedurat e provimit, transferimin ose ndërprerjen e studimeve (Evd 66). Për më tepër, studentët këshillohen për procesin e diplomimit, diplomën dhe procedurat për plotësimin e studimeve të tyre etj, me zyrat përkatëse. Gjatë takimit me studentët ata na tha që kanë kontakte të vazhdueshme me pedagogët e tyre të cilët i udhëzojnë në lidhje me hartimin e tezës së diplomës. (Evd 67 dhe 68). |
| Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Një udhëzues elektronik i detajuar është gjeneruar për studentët (Evd 90 dhe 123). Cdo pjesëtarë i stafit akademik mban një regjistër të saktë të aktiviteteve, i cili dorëzohet në fund të çdo semestri (Evd 99). Dekanati organizon takime të rregullta për të diskutuar proceset mësimore dhe bashkëveprimet e studentëve. Një përfaqësues i studentëve është i pranishëm në këto takime (Evd 87). |
| Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet | Aktualisht, kontrolli i plagjiaturës bëhet nga udhëheqësit e diplomave. Nga |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | takimi me rektorin, u deklaruan përpjekjet për platformën elektronike antiplagjiature në lidhje me temat e diplomës dhe kërkimin shkencor. Aktualisht në kuadër të iniciativës të ministrisë përgjegjëse për arsimin (MASR) do të ofrohet falas për IAL-të publike. | | | |
| Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve | Ndërkohë studentëve u vihet në dispozicion informacioni i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Informacioni mundësohet përmes sistemit të menaxhimit ESSE3 i cili është i arritshëm nëpërmjet internetit | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | UMT ka detyrimin të ruajë informacionin, dokumentacionin dhe arritjet e studentit. (Evd 1 dhe 2). Për secilin student të regjistruar, krijohet një dosje që përmban informacione mbi arsimin e mesëm dhe formimin e tyre (Evd 100). Zyrat e sekretarive janë në gjendje të gjenerojnë të gjitha raportet e studentëve dhe përparimin e tyre dhe kjo mundësohet nga sistemi elektrik ESSE3 (Evd 52). Përmes këtij sistemi gjenerohen gjithashtu edhe të gjitha notat e provimeve (Evd 54) si dhe informacione mbi diplomën dhe mbikëqyrësit e tyre (Evd 104), transferimin e studentëve (Evd 103) dhe botimet e Studentëve (Evd 111). |
| Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e integruar të studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Kopjet fizike të këtyre dokumentave mirëmbahen gjithashtu nga sekretaria. Këto dokumente arkivohen për ruajtje afatgjatë (Evd 131) dhe u ofrohen studentëve falas. Ky sistem mundëson gjenerimin e raporteve të shpeshta, duke i mundësuar stafit dhe studentëve të monitorojnë përparimin e tyre. Bazuar në aktet e brendshme, studentët kanë të drejtën e tërheqjes së dosjes individuale, por duke lënë në arkivë një kopje të saj të siguar nga personi dhe arkiva [Ev.100]. |
| Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimit, deri në diplomimin e tyre. | Gjatë vizitës tonë, ne patëm mundësinë për të vizituar zyrën e sekretarit dhe u impresionuam me punën e bërë nga stafi për të siguruar ruajtjen sa më të mirë të regjistrave dhe konfidencialitetin e të dhënave. |
| Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të | Të gjithë departamentet janë në gjendje në çdo kohë të analizojnë të dhënat e studentëve nëpërmjet regjistrat "hardcopy" që sekretaria mësimore mban, si edhe të analizojnë të dhënat e gjeneruara nga sistemi ESSE3. [Ev.84], gjithashtu edhe të hartojnë raporte analitike në lidhje me cilësinë e studentëve që ndjekin |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | këtë program studimi. | | | |
| Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve | Edhe vetë studentët kanë mundësinë që të përmes numrit të matriculimit mund të shikojë vetëm ecurinë e tij në sistem dhe të marrë të dhëna për këtë. | | | |
| | UMT disponon të dhëna për studentët dhe personeli. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të menaxhimit, i cili siguron garanci dhe siguri për integritetin e të dhënave. Studenti regjistrohet në sistem dhe të dhënat e tij janë të sigurta pasi sistemi regjistron automatikisht çdo editim, ndërhyrje, kohën e ndryshimit dhe llogarinë nga ka ardhur ndryshimi.. Universiteti i Mjekësisë si institucion publik ka detyrim ligjor raportimin periodik në MASR për studentët e regjistruar. Ndërkohë UMT analizon cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Nëpërmjet projektit GRADUA regjistrohen studentët pas diplomimit, punësimit i tyre etj. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | UMT e përfshin studentin në shumë mënyra, si për shembull ata janë pjesë e senatit akademik dhe NjSBC (Evd 14). Studentët kanë të drejtën të sugjerojnë tema të reja të lëndës, të kërkojnë ulje të tarifave, ri-aktimin e datës së provimit (Evd 45) dhe këto kërkesa diskutohen plotësisht në mbledhjen e Dekanatit dhe marrin përgjigje. |
| Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Studentët kanë organizatën studentore, të quajtur KSFM, i cili përcjell zërin e tyre te strukturat akademike. (Evd 121). GVJ konstaton se përfshirja e studentëve në procesin e përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies në programin e studimit është i vazhdueshëm dhe bazohet në bashkëpunimin student pedagog dhe për këtë FM motivon studentët për bashkëpunim të vazhdueshëm. . [Evd.122] KSFM nga ana tjetër organizon aktivitetet e veta (p.sh. ligjëratat, ditët e hulumtimit) me ndihmën dhe përfshirjen e stafit akademik, (Evd 120) ku studentët janë të mirëpritur të marrin pjesë në këto aktivitete. |
| Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të | Ankesat e Studentëve, sugjerimet për kurrikulën akademike janë marrë në konsideratë dhe kanë marrë përgjigje (Evd 148, Evd 66, Evd 61). Pas protestës së studentëve vitin e kaluar, u implementua ulja e tarifave. Prej janarit 2019, UMT ka marrë hapa konkretë për plotësimin e nevojat e studentëve. UMT garanton përfshirjen e studentëve jo vetëm në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit, por |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| pjesshme të mëparshme. | reflekon sugjerimet e tyre në përmbajtje të programit. | | | |
| Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to. | Në vendimin e përbashkët Senat akademik – Bordi i Administrimit, përfshirja e studentëve dhe informimi i tyre është më e madhe. Ndërkohë e drejta për kryerjen e procesit të vlerësimit, ankimimi i rezultatit rezultojnë të jenë të garantuara | | | |
| Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.6

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. | UMT inkurajon pjesëmarrjen në konferenca shkencore, mobilitetin e stafit dhe studentëve si dhe bashkëpunimin me partnerë të huaj. Një agjendë i të gjitha këtyre aktiviteteve mbahet çdo vit duke vënë në dukje numrin e stafit dhe studentëve të përfshirë në aktivitetet kërkimore bashkëpunuese, publikimet dhe projektet e financuara (Evd 116). |
| Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta. | Inkurajohet shumë pjesëmarrja në konferenca dhe ditë kërkimore. (Evd 115). UMT promovon pjesëmarrjen në projektet bashkëpunuese të BE-së, ku informacionet mbi thirrjet për financim dërgohen rregullisht (Evd 108) në mënyrë që të promovojnë bashkëpunimin me universitetet e huaja. Një listë e këtyre bashkëpunimeve përpilohet dhe raportohet çdo vit (Evd 26). Ne strukturën e riorganizuar të UMT, është miratuar një strukturë specifike në lidhje me projektet kërkimore e cila do bëjë të mundur pjesëmarrjen dhe menaxhimin e një numri më të madh të projekteve të BE-së. Kjo do të ishte e dobishme si për studentët ashtu edhe për stafin akademik, duke rritur mundësitë për kërkime shkencore. |
| Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe të publikojnë studime e punime shkencore. | |
| Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore-shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve. | Pjesëmarrja e studentëve në kërkime shkencore inkurajohet përmes punimit të tyre përfundimtar, ku studentët punojnë ngushtë me udhëheqësit e tyre për të përgatitur tezën e diplomës (Evd 75 dhe 110). Këto punime diplome mirëmbahen në zyrën e sekretarisë në format elektronik dhe fizik. Punimet |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave. | prezantohen para komisionit të diplomimit të cilët vlerësohen në përputhje me rezultatet e arritura. Punimet më të mirë inkurajohen studentet të publikojnë falas me mbështetjen e stafit akademik në buletin shkencor UMT. | | | |
| Kriteri 6. Personeli akademik mbështet studentët në kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës | Përmes ëorkshopeve të organizuara nga zyra e karrierës studentët në marrin ndihmë në përgatitjen e punimit të diplomes, PPT si dhe hartimin e dorëshkrimeve. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.7**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit | UMT ka një sërë bashkëpunime të frytshme me institucione të tjera kryesore shqiptare (për shembull Fakultetin e Ekonomisë) si dhe organizata të huaja me qëllim promovimin e pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në kërkime (Evd 86). Shkëmbimet e stafit. Lëvizshmëria dhe pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare janë një aspekt i rëndësishëm i UMT, e cila e monitoron, raporton dhe promovon atë (Evd 116, 107, 84). Kjo ka bërë që, përveç anëtarëve të vjetër të stafit, anëtarët më të rinj të stafit akademik dhe studentët të përfshihen në skemat e lëvizshmërisë dhe shkëmbimit, (Evd 34, 90, 31, 32). Gjatë diskutimit me studentët, u bë e qartë se si stafi ashtu edhe studentët ishin të vetëdijshëm për mekanizmat e përdorur për të marrë pjesë në programe të tilla mobiliteti dhe shkëmbimi, dhe gëzonin mbështetjen dhe inkurajimin e plotë nga UMT për të marrë pjesë në to. |
| Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve. | Ftesat për pjesëmarrjen e ekspertëve të huaj në UMT janë një ngjarje e zakonshme për të (Evd 82), dhe sigurojnë vijueshmërinë e Institucionit në përputhje të plotë me zhvillimet më të fundit të fushës. |
| Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj vendës dhe të huaj në projekte kërkimore. | Duke mbajtur këto standarde të larta bashkëpunimi, UMT gëzon një reputacion të lartë midis kolegëve dhe bashkëpunëtorëve të huaj (Evd 136). Për shkak të buxhetit të kufizuar, këto aktivitete organizohen përmes sponsorizimeve (p.sh. spitalet private) ose lidhjeve personale. |
| Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj. | Personeli i ftuar në vite ka kontribuar për të rritur profilin ndërkombëtar të fakultetit dhe universitetit. Një pjesë e veprimtarive janë në funksion të kërkimit dhe mësimdhënies. Nga deklaratimet e studentëve rezulton se në vitet e fundit personeli akademik dhe studentët janë angazhuar në projekte |
| Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare. | |
| Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, | |

| | | | | |
|---|--|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore | të ndryshme mobiliteti për periudha të ndryshme kohore | | | |
| Shkalla e përbushjes së standardit | Nuk përbushet | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | UMT përdor faqen e saj të internetit për të publikuar informacione të rëndësishme për studentët; sidoqoftë, një udhëzues për studentët është publikuar dhe është në dispozicion të tyre duke siguruar informim të mirë (Evd 90). Informacioni është gjithashtu i disponueshëm në zyrat e sekretarisë (Evd 109) dhe bibliotekës. |
| Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | UMT ka një zyrë të veçantë për këshillimin mbi karrierën (Evd 88, 89) e cila i vjen në ndihmë studentëve në lidhje me zgjedhjet e tyre akademike dhe mundësitë e ardhshme për punë. Institucioni organizon ditët e karrierës duke ofruar këshilla për intervista, aplikime për punë dhe përgatitjen e CV-së, si dhe ndërveprime të drejtpërdrejta me punëdhënësit e ardhshëm (Evd 92). |
| Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Projekti Gradua (EVD 96) mundëson mbledhjen e informacionit për studentët e diplomuar, përparimin e tyre, duke ndihmuar me mundësi punësimi dhe ruajtjen e lidhjeve me institucionin në fjalë. Në përfundim të këtij projekti në 2 vitet e ardhshme, do të mundësojë një qasje të qëndrueshme dhe elektronike në informacione që lidhen me të gjithë të diplomuarit dhe përparimin e tyre në vazhdimësi. Zyra e karrierës gjithashtu mirëpret studentët e arsimit të mesëm të vitit të fundit për të kaluar një ditë në UMT, e cila u jep atyre njohuri për jetën si student i mjekësisë dhe i përgatit ata për zgjedhjet e tyre të ardhshme në Universitet (Evd 89). Siç u shprehëm më sipër, zyra e karrierës zhvillon një punë të shkëlqyer. |
| Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse | Përmes KSFM-së, ankesat e studentëve dëgjoen dhe veprohet mbi to. Për shembull, një rritje e mundësive për të shtuar numrin e datave të provimeve është zbatuar pas kërkesës së studentëve. Përdorimi i pyetësorëve të shpeshtë elektronik dhe anonim është përdorur si një metodë indirekte për mbledhjen e reagimeve të studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies dhe mbështetjes të ofruar nga UMT. Kontakti i drejtpërdrejtë i studentëve me stafin ishte i dukshëm edhe gjatë diskutimeve që kemi pasur me studentët nga të gjitha vitet, ata ishin të lumtur të kishin komunikim me pedagogët e tyre dhe të kërkonin informacione dhe |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | seminare shtesë në fushat dhe seanca laboratorike që kishte mangësi. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TËSTUDIMIT

| Standardi VI.1 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënljgore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | GVJ kontaston se kriteret e këtij stanatndardi janë të plotësuar. Në zbatim të ligjit ligjin për arsimin e lartë LAL 80/2015, neni 103, standardeve shtetërore të cilësisë (Kodit të cilësisë), standardeve të hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë (ESG), UMT implementon dhe zbaton një sistem të konsoliduar të sigurimit të cilësisë. [Ev.9-11] Institucioni ka të sanksionuar në Statutin e vet përgjegjësinë institucionale për sigurimin e cilësisë në nivel institucional, programeve të studimit dhe aspekteve të veçanta të mësimdhënies e mësimnxënies. [Ev.1] Angazhimin institucional për krijimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë, UMT e ka parashikuar edhe në Planin e zhvillimit strategjik 2017-2020 në të cilin parashikohet përgjegjësia institucionale për konsolidimin e cilësisë dhe mekanizmat me të cilat kjo do të arrihet. [Evd.4] |
| Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Ne UMT, funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [Evd.9] e cila harton procedura dhe politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional [Evd.10], në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe kodin e cilësisë. NJSBC është organi kryesor i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional dhe bashkëpunon me përfaqësuesit e saj në çdo njësi kryesore. Në zbatim të detyrimeve që lindin në përmbushje të standardeve dhe kriterëve të sigurimit të cilësisë dhe përcaktimeve të NJSBC në nivel institucional. FM ka të përcaktuar personin përgjegjës i cili koordinon procesin e sigurimit të cilësisë në Fakultet dhe bashkërendon punën me NJSBC në nivel institucional (evidenca përkatëse per ngritjen e NJSBC dhe rregullorja e funksionimit të NJSBC) |
| Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e | |

| | |
|--|--|
| <p>përmirësojnë cilësinë.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p> | <p>Për garantimin e cilësisë në nivel fakulteti, GVJ konstatoi se janë ngritur komisione ad-hoc, të cilat kanë kryer vlerësime dhe analiza tematike.</p> <p>Për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, FM nëpërmjet komisioneve ad-hoc, ka përdorur instrumentet standarde për mbledhjen e informacionit sikundër janë takimet dhe sondazhet me studentët. Komisioni ka përgatitur një set pyetjesh të cilat janë shpërndarë tek studentët për tu plotësuar në mënyrë anonime. Më pas janë analizuar të dhënat dhe është finalizuar procesi (evidence e analizës së pyetësoreve)</p> <p>Në nivel fakulteti, kryhet vlerësimi i performancës të personelit akademik në lidhje me ofrimin cilësor të programit të studimit, jo vetëm në aspektin e mësimdhënies, por dhe në aspektin e kërkimit shkencor, kontributit për institucionin.</p> <p>Përgjegjësit e departamenteve në përfundim të vitit akademik plotësojnë performancën e stafit akademik përkatës. Për secilin pedagog me kohë të plotë dhe të pjesshëm bëhet vlerësimi sipas formularit të performancës (evidencë moel formulari) plotësimi i së cilit bazohet në përgatitjen në kohë të syllabuseve, literaturës së përdorur, zhvillimi i leksioneve, praktikave, seminareve dhe laboratoreve, respektimi i orarit të mësimi, udhëheqjet për detyra kursi apo tema diplome.</p> <p>Gjithashtu bëhet vlerësimi i aktivitetit shkencor të stafit pedagogjik nëpërmjet evidentimit të artikujve të botuar dhe prezantimeve orale në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Përgjegjësit e departamenteve vlerësojnë gjithashtu dhe aktivitetin administrativ të pedagogëve duke vlerësuar korrektesën në kryerjen e tyre, realizimin e shërbimeve ndaj studentëve, respektimin e afateve kohore të këtyre aktiviteteve dhe të rregullores së fakultetit.</p> <p>Plotësimi i performancës së stafit akademik i bëhet me dije Dekanit dhe depozitohet në Dekanat. Në përfundim të këtij procesi është hartuar raporti paraprak i cili është vënë në dispozicion të titullarit të fakultetit.</p> <p>Vlerësimi nga stafi akademik është mekanizëm nëpërmjet të cilit është synuar jo vetëm forcimi i kulturës së cilësisë në nivel institucional, por referuar raporteve analitike përkatëse [Ev.12]. NJSBC ka orientuar titullarët e institucionit e më tej dhe organet kolegjiale, për përmirësimin e praktikave dhe procedurave administrative me qëllim objektivin për rritjen e motivimit të personelit akademik.</p> <p>Të gjithë analizat /raportet/të dhënat e dala nga procese vlerësimi janë pjesë e raporteve vjetore në nivel departamenti/fakulteti/universiteti, duke evidentuar problematika sipas aspekteve dhe adresuar ato për zgjidhje, proces ky i vazhdueshëm lidhur me përmirësimin e cilësisë (raporte vjetore të FM)</p> <p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë sikundër është përcaktuar në Kodin e cilësisë dhe Manualin e vlerësimit të jashtëm të hartuar nga agjencia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë ASCAL.</p> <p>Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, në 2017, realizoi për të parën herë procesin e vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit institucional nga QAA dhe ASCAL, dhe është akredituar me një nga vlerësimet më pozitive në institucionet publike për një periudhë 5 vjeçare [Ev.15]. Proceset e vlerësimit</p> |
|--|--|

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>të brendshëm apo të vlerësimit të jashtëm institucional i UMT, kanë qenë pjesë e diskutimeve, e adresimit të problematikave dhe vetë rregullimit dhe në dokumentet themelore të UMT dhe të njësive përbërëse të tij [Ev.22]. Arritja e këtij rezultati tregon se UMT dhe njësitë përbërëse, ndjekin dhe zbatojnë politika të qarta për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Politikat, procedurat për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në programet e studimit që ofron UMT, janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e NJSBC [Evd.11] dhe në aktet rregullative të institucionit.</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë. | <p>Në mënyrë periodike bëhet monitorimi i leksioneve dhe seancave laboratorike (Evt 141). Çdo kurs ka një drejtues të modulit, i cili monitoron nga afër performancën e stafit (Evt 66). Siç përshkruhet në VI.1, pjesë e këtij procesi është edhe vlerësimi i stafit (Evt 84, 85).</p> <p>Ekziston një procedurë e detajuar për krijimin e moduleve të reja (Evt 46) dhe planifikimin e të gjitha leksioneve për programet BSc dhe MSc (Evt 47).</p> |
| Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë. | <p>Nga NJSBC kryhet një analizë vjetore, e cila është shumë e rëndësishme për të vlerësuar cilësinë e programit të studimit në përputhje me standardet institucionale dhe strategjinë e vetë IAL.</p> <p>Për të monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, NJSBC përdori pyetësorët e studentëve si edhe vlerësimin nga shefat e departamenteve.(Evt 97). Pasi përpunohet pyetësorët dhe mbildhëen të dhëna nga shafat e departamenteve NJSBC, harton disa raporte analitike të cilat në pas bëhen pjesë edhe e raportit vjetor që dorëzohet në MASR.</p> |
| Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. | <p>Gjatë takimin me NJSC na u tha se pjesë e punës së kësaj njësire është edhe realizimi ose hartimi i analizave të ndrydhme. Këto analiza janë përmbledhje për personelin akademik të angazhuar në program, përditësimi i literaturës së programit, rezultatet e studentëve (kalueshmëria dhe nota mesatare), marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, infrastruktura në funksion të programit, duke e përmbyllur raportin me analizën përfundimtare dhe plan masash për përmirësim. [Evt.84]</p> |
| Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | <p>Ristrukturimi i vazhdueshëm synon të prezantojë metoda të automatizuara dhe të paanshme të vlerësimit të stafit (Evt 6). Për më tepër, ka planet për të zhvilluar dhe prezantuar korigjimin elektronik të provimeve (në rast të zgjedhjes së pyetjeve të shumëfishta), të cilat do të rrisin objektivitetin e</p> |
| Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe | |

| | | | | |
|---|---------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë | vlerësimit të studentëve. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Sub përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtijshme të studentëve.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p> | <p>Përmirësimi dhe përditësimi i programeve të studimit kryhet rregullisht (Evt 46, 47). Modulet vlerësohen në nivele të shumëfishta duke filluar me NJSBC, më pas drejtuesi i modulit, informacioni i marrë nga pyetëtori i studentëve (Evt 97), kontakti i drejtpërdrejtë me studentët, shefi i departamentit, zyra e sekretarit etj.</p> <p>Nga NJSBC na u tha se metodat e vlerësimit të cilësisë bazohen në disa mekanizma kryesorë që janë mekanizma kryesorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi nga NJSBC në nivel institucional - Monitorim i vazhduar nga koordinatori i programit të studimit - Vlerësime nga komisione ad-hoc të ngritura nga Dekani i fakultetit. Realizim sondazhesh dhe mbledhje informacionesh nga studentët - Monitorime nga drejtuesit e departamentit - Monitorime nga zyra e burimeve njerëzore dhe sekretaria mësimore <p>Futja e teknologjive më të fundit (Evt 117) dhe Qendra e Simulimit është thelbësore për përmirësimin e aftësive praktike dhe klinike të studentëve (Evt 151).</p> <p>Kjo e fundit është parashikuar të zbatohet në vitin e ardhshëm. Përmirësimi i teknologjisë diskutohet gjithashtu në vlerësimet vjetore të bëra për stafin akademik dhe në nivel fakulteti. Inkurajohet dhe monitorohet edhe përfundimi i studimeve të doktoratës dhe masterit, i cili në përfundim duhet të rezultojë në cilësi më të mirë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Tregues të tjerë të cililit shërben për të vlerësuar cilësinë e programit të studimit janë rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, të tillë si: provimi i shtetit, rezultatet e edukimit në vazhdim ku fakulteti gjithnjë ka mbledhur këto evidenca</p> |
| <p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p> | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p> | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e</p> | |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p> | <p>Gjatë diskutimeve, u evidentua se pjesa më e madhe e stafit akademik dhe klinik i të këtij programi, janë të përfshirë në projekte të BE-së, ose të përfshirë në organizimin e aktiviteteve jasht-kurrikulare për studentët.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Të gjitha strukturat e UMT janë përgjegjëse për monitorimin dhe garantimin e një cilësie të lartë në mësimdhënie dhe kërkimit shkencor (Evt 1, 3, 58, 11).</p> <p>Stafi dhe studentët janë të përfshirë në të gjitha aspektet e mësimdhënies duke siguruar që çdo çështje e ngritur adresohet dhe zgjidhet me efikasitet.</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> | <p>Planet e punës dhe ngarkesat mësimore diskutohen paraprakisht (Evt 45, Evt 12, 97). Shpesh herë ngrihen grupet Ad Hoc për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, një aspekt ky që përbën një pjesë kryesore të vlerësimit të stafit.</p> <p>Gjatë bisedave që kemi pasur me stafin mësimdhënës, u evidentua se ata mbulojnë lëndë në fushat e tyre të ekspertizës. I gjithë stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka në eksperiencë të gjatë në fushën e mësimdhënies dhe janë ndër specialistët më të mirë të fushave mjekësore që ata mbulojnë.</p> |
| <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Gjatë takimit më stafin akademik një problem që doli ishte grupi i madh i studentëve në praktika dhe seminare klinike, të cilën UMT kishtë menduar ta rregullonte përmes futjes së tutorëve.</p> <p>Raporti vjetor i UMT tregon se egziston kultura e “të gjithë janë përgjegjës” dhe kultura tolerante, e cila krijon një mjedis të këndshëm pune dhe studimi, dhe është një pikë e fortë e UMT.</p> |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> | | | | |
| <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p> | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
| | | | | <p>X</p> |

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p> | <p>UMT zbaton një politikë të hapur përsa i përket aktiviteteve të saj strategjike. UMT fton studentët dhe stafin të njihen me procedurat (Evt 3).</p> <p>NJSBC gjatë takimit na tha se UMT realizon takime periodike me studentët dhe përfaqësuesit e tyre në organet kolegjiale të institucionit me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit [Evt.120]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> | <p>Në faqen Ëeb të UMT publikohen raporte të rregullta mbi stafin dhe punën e studentëve, njoftime në lidhje me përmirësimet e mësimdhënies, vlerësimin nga ekspertë të huaj.</p> <p>NJSBS përdor metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për të vlerësuar efektivitetin e mësimdhënies sic janë:</p> |
| <p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p> | <ul style="list-style-type: none"> - ngritja e grupeve vlersuese ad-hoc, - përmes pyetësorëve anonimë dhe elektronikë, - pyetjeve të drejtpërdrejta të studentëve, - kontakti me stafin dhe monitorimi i ligjëratave / seminareve. |
| <p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në</p> | <p>Çështjet dhe pikat e veprimit ndiqen dhe diskutohen nga Senati (Evt 45), i cili</p> |

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| vijim të cilësisë së programit të studimit. | siguron që këto të adresohen dhe plotësohen përmes veprimeve specifike. | | | |
| Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit | <i>Për momentin, prioriteti kryesor i vendosur nga UMT është akreditimi i programeve të studimit, dhe për këtë arsye identifikimi i institucioneve partnere, krijimi i qendrës së simumlimit, inkurajimi i stafit dhe pjesëmarrja e studentëve në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, publikime, studime pasuniversitare dhe krijimin e rrjetit të ekselencës janë përcaktuar si përparësi.</i> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Integruar “Mjekësi e Përgjithshme” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Mjekësisë, Tiranë”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni ka eksperiencën më të gjatë (prej më shumë se 67 vitesh) të kontributit në formimin e brezave të tërë mjekëve dhe profesionistëve të shëndetësisë në vend. Niveli i lartë mjekësisë shqiptare është meritë dhe kontribut i këtij fakulteti.
2. Institucioni ofron ekspertizë në kërkimet klinike, falë partneritetit me qendrat shëndetësore universitare në vend që në krijimin e këtij institucioni.
3. Partneriteti me qendrat shëndetësore universitare, ofron mundësi të shkëlqyera për studentët që të kenë kontakte të drejtpërdrejta me pacientët që nga fillimi i studimeve.
4. Cilësia në hyrje e studentëve që regjistrohen në programin e studimit është më e larta në vend. Institucioni ka procedura transparente dhe të qarta në përzgjedhjen e aplikantëve në hyrje në këtë program studimi.
5. Institucioni disponon kapacitete akademike dhe infrastrukturore në funksion të të programit të studimit për realizimin me cilësi të procesit të mësimdhënies. Kjo referuar arritjeve të lartë në fushën e mjekësisë në vend.
6. Komunikim i shkëlqyer student-staf, i cili siguron përmirsimin e mësimdhënies dhe e bën atë proaktive.
7. Institucioni ka mekanizma efikas për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies, stafit akademik si dhe të studentëve.
8. Përfshirja e studentëve në vendimarrje dhe jetën akademike të UMT është në nivel të lartë. Institucioni siguron që zëri i tyre të dëgjohet në të gjitha nivelet dhe kërkesat/ankesat e tyre të trajtohen në mënyrë efektive.
9. Institucioni ofron specializime afatgjata në fushën e mjekësisë, mbështetur në kapacitetet e stafit akademik dhe infrastrukturën spitalore universitare që ka në dispozicion.
10. UMT disponon sisteme të brendshme të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit (monitorimin e studentëve, regjistrimin e të dhënave personale dhe rekrutimin e tyre).
11. Institucioni ndjek dhe zbaton politika strategjike dhe menaxheriale të hapura dhe transparente.
12. Institucioni mbështet fuqimisht studentët në aktivitetet ekstrakurrikulare nëpërmjet strukturave të ngritura në shërbim të tyre, ofron këshillim karriere, kërkesat e studentëve shqyrtohen dhe analizohen në kohë reale.

- Këshilla për karrierë dhe rekrutim për studentët. Mbështetja e aktiviteteve jashtëshkollore të studentëve. Aftësia për t'u përgjigjur shpejt kërkesave të studentëve
13. Personeli akademik i institucionit është i përkushtuar në realizimin e veprimtarive akademike të ndërthurur me formimin praktik dhe klinik të studentit.
 14. Institucioni dukshëm bën përpjekje për të përfshirë studentët në projektet kërkimore.
 15. Insitucioni nëpërmjet strukturave administrative ndihmës akademike dhe sekretarisë mësimore ofron mbështetje efektive për stafin dhe studentët.
 16. Të diplomuarit në mjekësi të përgjithshme (profesion i rregulluar) dalin me një formim cilësor në fushën e mjekësisë, duke i mundësuar tashmë një treg pune ndërkombëtar.
 17. Afirmim konsiderohet vështirësia në qasjen e fondeve e alokuara nga projektet e BE-së.
 18. Afirmim konsiderohet gjetja e institucionit që nëpërmjet mbikqyrësve/(tutorëve klinikë të bëjë të mundur uljen e numrit të studentëve në grupe për seminare/praktikë klinike, aktualisht nr i studenteve/grup është 10-15 studentë, ndërkahe që akti rregullator përkatëse parashikon deri në 25 studentë).

Pikat për tu përmirësuar në të ardhmen:

1. Fuqizimi i mëtejshëm i zyrës së marrëdhënieve ndërkombëtare.
2. Ofrimi i programeve në gjuhën angleze.
3. Përditësi/shtimi i informacioneve në faqen zyrtare të web në gjuhën angleze.
4. Rritja e mëtejshme e fonde për kërkimit shkencor për këtë program studimi.

Rekomandime

1. GVJ rekomandon fuqizimin e mëtejshëm të zyrës së marrëdhënieve ndërkombëtare me qëllim ndihmën në hartimin, menaxhimin dhe financat, dhe auditimin e tyre, për të rritur shkëmbimet e studentëve / stafit dhe pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare kërkimore. Gjithashtu kjo mund të ndikojë në gjenerimin e fondeve për kërkimin shkencor.
2. Të shihet mundësia e ofrimit të programeve mësimore në gjuhën angleze, qasje që do të ndihmojë në rekrutimin e studentëve të huaj.
3. Të përditësohet/plotësohet faqa zyrtare e web në gjuhën angleze ashtu si ajo shqipëtare.
4. GVJ rekomandon, qasjen e studentëve për të gjetur punë jashtë vendit menjëherë pas diplomimit, duke krijuar kështu fenomenin e "migrimit të trurit mjekësor", duhet të vihet në vëmendjen e qeverisë, të cilës duhet ti adresohet ky rekomandim, para se mungesa e furnizimit të mjekëve në vend të bëhet e pazgjidhshme.

Summary Conclusions of the External Evaluation Report, of the Integrated Master of Science program in “General Medicine”, of the Higher Education Institution “University of Medicine, Tirana”

Strengths and Affirmations:

1. The institution has the longest experience (of more than 67 years) of contributing to the formation of generations of physicians and health professionals in the country. The high level of Albanian medicine is the merit and contribution of this faculty.
2. The institution provides expertise in clinical research, thanks to partnerships with university health centers in the country since the establishment of this institution.
3. Partnerships with university health centers provide excellent opportunities for students to have direct contact with patients from the beginning of their studies.
4. The incoming quality of students enrolling in the study program is the highest in the country. The institution has transparent and clear procedures in the selection of incoming applicants in this study program.
5. Institution has academic and infrastructural capacities in function of study program for quality realization of teaching process. This referred to the high achievements in the field of medicine in the country.
6. Excellent student-staff communication, which ensures teaching improvement and makes it proactive.
7. The institution has effective mechanisms for monitoring the quality of teaching, academic staff and students.
8. Student's involvement in UMT decision making and academic life is at a high level. The institution ensures that their voice is heard at all levels and their requests / complaints are dealt with effectively.
9. The institution offers long-term specializations in the field of medicine, based on the capacities of the academic staff and the university hospital infrastructure available.
10. UMT has internal data and information management systems (student monitoring, personal data and recruitment recordings).
11. The institution pursues and implements transparent strategic and managerial policies.
12. The institution strongly supports students in extracurricular activities through the structures set up in their service, provides career counseling, student requests are reviewed and analyzed in real time.
13. The academic staff of the institution is committed to conducting academic activities intertwined with the practical and clinical training of the student.

14. The institution is making significant efforts to include students in research projects.
15. The institution provides effective support for staff and students through the academic administrative support structures and teaching secretariat.
16. Graduates of general medicine (regulated profession) have a qualitative formation in the field of medicine, being able to work in international job market.
17. Affirmation is considered the difficulty in accessing funds allocated by EU projects.
18. Affirmation is considered the finding of Institution that through supervisors / (clinical tutors) it is possible to reduce the number of students in groups for seminars / clinical practice, currently the number of students / group is 10-15 students, while the relevant regulatory act provides up to 25 students).

Points for future improvement:

1. Further strengthen the office of international relations.
2. Offering English language programs.
3. Updating / adding information to the official web site in English language.
4. Further increase of research funding for this study program.

Recommendations:

1. The EEG recommends further strengthening the office of international relations with the aim of assisting in the design, management, financing and their audit, to increase student / staff exchanges and participation in international research projects. It may also affect the generation of research funding.
2. To consider the possibility of offering programs in English language, an approach that will help recruit foreign students.
3. To Update / complete the official web site in English just like the Albanian one.
4. The EEG recommends that students' approach to work abroad immediately after graduation, thereby creating the phenomenon of "medical brain migration", be brought to the attention of the government, to which this recommendation must be addressed before the absence of supply of doctors to the country becomes insoluble.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|--|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |